

## DREJTËSI

Reformat në gjyqësor pas Referendumit

Fq.5



## SHËNDETËSI

Fond i veçantë për ilaçe të tjera

Fq.6



Për çdo vrimë!

Forum

Fq.11



# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3456 · e martë, 11 shtator 2018

18°C | 28°C

15 DEN



KOHA për kulturë

Fq.12-15

## FORUM

Vizita e Vuçiqit dhe impotentca e Thaçit dhe Jasharëve



Nuk mundesh të jesh brilant në diplomaci me Serbinë, nëse udhëheqë si Pashë impotent, ashtu siç sillet Presidenti Thaçi, që i mungojnë numrat në parlament, impotencë në qeverisje, siguri, e sidomos mos kooordinim dhe dëgjim i komandantave

Fq.10

## AKTUALE

Me regjistrim të veturës, kartoni i gjelbër i detyrueshëm

Fq.7

## GLOBI

Evropa përballë valës së ekstremit të djathtë?

Fq.18



## QËNDRIMI I PARTIVE SHQIPTARE RRETH REFERENDUMIT

# TË GJITHË JANË PËR, POR ME NUANCA



Vetë fakti se të gjitha partitë shqiptare kanë formuar shtabe qendrore dhe shtabe lokale flet për një përqëndrim të forcave partiake për të rritur ndikimin në elektoratin shqiptar, para zgjedhjeve presidenciale apo dhe zgjedhjeve të mundshme parlamentare në prill të vitit të ardhshëm kjo për shkak të rrethanave të reja politike që do të sjell referendumi për emrin

Fq.3

## Mekanizëm që siguron cilësi – i domosdoshëm

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) po punon vazhdimisht për të përgatitur një test të ri i cili do të paraqesë mekanizëm për kontrollimin e nivelit dhe cilësisë arsimore të nxënësve. Në bazë të zëvendës ministrit të MASH, Petar Atanasov i cili për portalin deca.mk pak ditë më parë kishte deklaruar se do të ketë një të ashtuquajtur testim nacional, ku nxënësit do të testohen dy herë gjatë arsimit fillore. Një testim

duhet të kryhet në klasën e katërt dhe tjetri në klasën e nëntë. Ky është model që aplikohet në Slloveni dhe do të merret si model në Maqedoni. Ndërkaq testimi do të kryhet nga Qendra e Provimit Shtetëror ku ekziston komision që ka program pune. Mirëpo nga MASH për Gazetën Koha hedhin poshtë idenë e një testimi nacional. Ata deklaruan se ende nuk kanë diçka konkrete rreth kësaj...

Fq.6



## EDITORIAL

KOSOVË-SERBI,  
NORMALIZIM  
I NJËNASHËM!

Emin AZEMI

Po ndodhë një normalizim i njëanshëm i marrdhënieve Kosovë-Serbi. Vjen Vuçiqi në veri të Mitrovicës dhe tregon se cilat janë planet e shtetit të tij për të shtri sovranitetin kulturor e financiar në territorin e Kosovës. Mbi muret e pendës së Ujmanit ngul flamuj serb dhe paraqitja e tij simbolike pranë këtij liqeni iu thotë liderëve të Prishtinës se Serbia është bashkëhënienike e resurseve natyrore të Kosovës. Mbi këta mure nuk kishte shkelë këmba e asnjë politikani të Kosovës dhe kjo nuk kërkon ndonjë sqarim plotësues se cila është harta e përkufizimeve të brendshme. Parajlmërimi i Vuçiqit për qindra milionë euro që do të investojë në vendbanimet serbe, shkon përtej kujdesit normal që duhet të tregojnë të gjithë politikanët për bashkëkombasit e tyre që jetojnë në shtetet fqinje. Kjo dëshmon edhe njëherë se Vuçiqi jo vetëm që nuk e ka ndërmend ta trajtojë Kosovën si fqij, por as ta njohë si shtet. Këtë e tha në mbarim të vizitës së tij në Mitrovicë. Ai sado që u mundua të adresojë kritika te opozitën e tij të politikës dhe kishës, megjithatë nuk e la pa e përmendur frymëzuesin dhe formësuesin e mendësisë së tij politike - Slobodan Millosheviqin. Si mos ta përmendte Millosheviqin ai, kur vetëm në kohën e tij politikanët si Vuçiqi dhe çetnikët tjerë mund të bënin karrierë në kurriz të popujve tjerë, përfshi edhe shqiptarët.

Zyrat e Bashkimit Europian në Bruksel të hënën janë kujdesur shumë për mbarëvajtjen e axhendës gjeryse të Vuçiqit. Prej andej madje erdhi edhe një brengosje për pengesat që iu bënë atij gjatë lëvizjeve nëpër Kosovën qendrore. Ende në Bruksel ka zyrtarë që besojnë se endjet provokuese të Vuçiqit nëpër Kosovë duhet kuptuar si "liri e lëvizjes". Ende në Bruksel nuk u dëgjua një zë kritik të shpreh brengosje se pse politikanët e Kosovës nuk mund të vizitojnë lirshëm Preshevën, Bujanocin e Medvegjën dhe pse çdo muaj gati ka ndalime arbitrare të kosovarëve që kalojnë nëpër rrugët e Serbisë.

Si ta kuptojmë këtë gjendje emocionale të zyrtarëve të Brukselit? Si quhet ky sindrom që shkakton brengosje në Bruksel vetëm kur ndonjë zyrtar serb nuk mund të sillte si të dojë në Kosovë? Pse Brukseli po e lejon këtë agresion të butë të politikanëve të Beogradit mbi Kosovën, ndërkohë që ende nuk e ka detyruar Serbinë që ta largojë Kosovën nga kushetuta e saj.

Kosova dhe Serbia nuk mund ti normalizojnë marrëdhëniet në mes veti me qasje të tillë joparimore të Brukselit. Në momentin kur NATO është futur në Kosovë (10 qershor 1999) dhe BE ka dërgu administratorë e gjykatës, ka pushuar edhe sahati i hegjemonisë serbe. Mirëpo nëse vazhdon të kultivohet edhe më tutje kjo përkëdheli e Brukselit kundrejt politikanëve provokatorë të Beogradit, atëherë i bie që segmente të caktuara të BE-së janë shndërruar në sallon rehabilitimi të politikave të vjetra në Ballkan, ku Serbia kishte primatin e luftënxitjeve e gjenocideve. Gojëkëqinjtë madje mund të thuan se Brukseli po mundohet të relativizojë kontributin amerikan në çlirimin e Kosovës, duke krijuar balanca artificiale ku Rusinë (përmes Serbisë) e nxjerr sërish faktor në rajon.

Europa sërish po luan në kartën e fshehtë të krijimit të realiteteve gjeopolitike pa SHBA-të si faktor vendimtar. Krimeja dhe Kosova kanë vetëm një K të përbashkët në emërtimet e tyre dhe këtu përfundon analogjia. Të gjitha të tjerat janë teori që imponohen për të komplikuar situatën në Ballkan.

## Sovraniteti linguistik i Kosovës

"Sociolinguisti serb me repute ndërkombëtare, Akademik Ranko Bugarski në një studim të tij Sociolinguistik rreth zhbërjes së ish Jugosllavisë, përmend edhe file e pavarësisë së Kosovës dhe thotë që Kosova vuri gurin themeltar të sovranitetit të saj shpirtëror dhe politiko-shtetëror kur e mori të drejtën që Kosovën ta quajë Kosovë, dhe fshiu Kosovën e Metohinë në vitet 70 dhe kur tok me këtë njohu gjuhën e vetme standarde shqipe, me të cilën i vu një digë të madhe përpjekjeve jugosllave për imponimin e shtetësisë së tyre shqiptarëve... Ky ishte hapi me të cilin, thotë ky, bota akademike kosovare e mbledhur rreth Mamut Bakallit ia hodhi zgjuarsisht establishmentit serb. E tani që Vuçiq e di studimin e akademik Bugarski, kurse ky derdimeni "negociues" nga ana kosovare nuk di gjë kur ka nisë pavarësia e Kosovës sipas Bugarskit, nuk di gjë edhe përse në "tavolinë negociimi" Vuçiq ka kthyer vetë të drejtën për ta quajtur Kosovo i Metohija dhe kjo është një ogur i keq se edhe "pajtimi historik" po të mos dështonte si tashmë quhet i dështuar, do ta mbante këtë emër-pushtimi, etj, etj.", ka komentuar në profilin e tij në Facebook zhvillimet në Kosovë, studiuesi Nijazi Muhamedi.

## Liria e Kosovës, 12 Qershor 1999

"Kërkesa për liri ishte e përhershme, por në vitin 1997 doli në sipërfaqe rezistenca e individëve e grupeve të vogla të armatosur me synim çlirimin e Kosovës. Gjatë vitit 1998 deri në vitin 1999 u dëbuan nga vendi rreth 900 mijë shqiptarë, u vranë rreth 13 mijë veta – mbi 95 % civilë- përfshirë mbi 200 masakra masive si Prekazi, Abria, Lybeniqi, Reçaku..., ku u zhdukën familje të tëra nga foshnjat disa muajshe, gratë shtatzëna e pleq 80 e 90 vjeçar, ngelen rreth 6000 të zhdukur. Janë dhunuar seksualisht rreth 20 mijë femra dhe meshkuj dhe u dogjën rreth 45 % e shtëpive dhe u shkatërruan pothuajse të gjitha pronat publike dhe të qytetarëve, dëmet e të cilëve ende nuk janë dëmshpërblyer kurrë. Përkundër gjendjes së jashtëzakonshme shumica absolute e të dëbuarve nga vendi, u kthyen, brenda një muaji-që është rekordi botërorë i kthimit të refugjatëve. Besimi dhe shpresa se Kosova fitoi Lirinë e shumë prituri, bëri që qytetarët të kthehen në atdhe pa asnjë garanci të jetës financuar dhe jo vetëm. Filloi ndërtimi i Kosovës, rifilloi jeta në liri pas ardhjes së KFOR-it. Liria e Kosovës nuk ishte vetëm një ëndërr, por edhe dukej si diçka e tillë. Kushdo që duartrokete Miloshevicin, pra po duartrokete krimet njerezore që janë bere ne Ballkan, nga kriminelit Slobodan dhe aprati i tij shtetëror", ka shkruar në profilin e saj në Facebook, gazetaria nga Prishtina, Behare Bajraktari.

## Më falni miq demokratë, por kravatat e Rames me pelqejnë!

"Shkrimtari gjerman Hans Falada, në rrefimin e tij autobiografik "Si u bëra shkrimtar", këshillon: Mos i thoni vetes kam lindur për të bërë këtë, apo ate profesion. Beni gjithçka që mundeni, derisa te vijë dita që do ta zbuloni talentin tuaj te vertete. Une isha 40 vjeç kur zbulova se kisha lindur për t'u bere shkrimtar. Edi Rama provoi të behej basketbollist, piktor, shkrimtar, gazetar, trafikant ikonash, ministër, piktor interieri, kryetar bashkie, poçar, skenograf urban, kryeminister... Derisa, ne moshen 54 vjeç, zbuloi se kishte lindur për t'u bërë dizenjator kravatash. Më mirë vonë se kurrë! Më falni miq demokratë, por kravatat e Rames me pelqejne!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook regjisori nga Tirana Kastriot Çipi

## MEDIACitate

## Thaçi: Nuk mund të vizitoj Luginën, jam i dënuar në mungesë nga Serbia

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se ai nuk mund të vizitojë komunat Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, ngase autoritetet serbe e mbajnë në fuqi dënimin ndaj tij. "Jam i dënuar në mungesë nga Serbia. Atë dënim Serbia nuk ma ka falur kurrë dhe as unë nuk e kam kërkuar atë falje. Unë nuk mund t'ia mësyj kufirit dhe të ballafaqohem fizikisht me policinë e Serbisë", tha Thaçi.

"Aktualisht, rrethanat janë të atilla që Beogradi nuk e sheh të dobishme e as të arsyeshme prezencën time atje. Nuk e kam bërë kurrë kërkesën, por e imagjinoj sjelljen e tyre", tha ai.

"Por, pavarësisht nëse e vizitoj apo jo, unë do të punoj ngushtë me përfaqësuesit e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit. Banorët e atjeshëm janë banorët më të diskriminuar në Evropë".

"Kosova nuk është vetëm Hashim Thaçi dhe ata që nuk mund të shkojnë në Serbi, sepse ishin bartës të luftës çlirimtare. Por, mendoj se ata që mund ta vizitojnë, mund ta bëjnë këtë pa pasur asnjë pasojë", tha presidenti i Kosovës pas takimit me përfaqësuesit e komunave Preshevë, Bujanoc e Medvegjë në Prishtinë.

Komentet e Thaçit pasuan debatet e shumta publike pas vizitës së presidentit serb, Aleksandar Vuçiq, në veri të Kosovës, sipas të cilave, tani do të duhej që edhe Thaçi të vizitonte Luginën e Preshevës.

(Klan Kosova, 10 shtator)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## DJATHI NË MESDHE DATON QË PARA 7000 VITESH

Prodhimi i parë i djathit në Mesdhe daton para më shumë se 7000 vitesh, kjo e vërtetueshme nga provat e gjetura në vazot qeramike në një vend arkeologjik në bregun dalmat të Kroacisë. Një studim që publikon revista "Plos One" për universitetin shtetëror të Pensilvanisë prezanton të dhëna të prodhimit të djathit përmes etapave të identifikimit të fermentimit të qumështit në enë të posaçme në rajonin mesdhetar që prej 7000 vjetësh. Në këtë studim ekipi i drejtuar nga Sarah McClure analizoi izotope të karbonit nga acidet yndyrore të ruajtura në vazot e ardhura nga fshatrat neolitike në bregun dalmat, në lindje të detit

Adriatik dhe gjetën të dhëna direkte të një prodhimi djathi shumë kohë më parë. Fshatrat e Pokrovnik-ut dhe Danilo Bitinj kanë qenë të banuara që prej 6000 dhe 4800 vitesh para krishtit dhe ruajnë disa lloje qeramikash që vinin nga i gjithë ky hark kohor. Banorët e këtyre fshatrave duket se përdorin një lloj qeramike të posaçme për ushqime të ndryshme dhe për nënprodukte të djathit. Këta të dhëna tregojnë se djathi filloi të prodhohej në Mesdhe para 7200 vitesh kur prodhimet e fermentimit të qumështit përbënin një burim të rëndësishëm të ushqimit për të gjitha moshat në popullatat e viteve të para të agrikulturës.

QËNDRIMI I PARTIVE SHQIPTARE RRETH REFERENDUMIT

# TË GJITHË JANË PËR, POR ME NUANCA

Vetë fakti se të gjitha partitë shqiptare kanë formuar shtabe qendrore dhe shtabe lokale flet për një përqëndrim të forcave partiake për të rritur ndikimin në elektoratin shqiptar, para zgjedhjeve presidenciale apo dhe zgjedhjeve të mundshme parlamentare në prill të vitit të ardhshëm kjo për shkak të rrethanave të reja politike që do të sjell referendumi për emrin



Sipas tij, më 30 shtator shqiptarët do të kenë mundësi të bëjnë ndarjen nga influencat jo të shëndosha që vazhdimisht i janë imponuar në periudha të ndryshme historike. "Shqiptarët janë pjesë e Evropës dhe perëndimit qysh në kohërat më të lashta dhe çdoherë kanë qenë pro këtij përcaktimi. Shqiptarët e shohin si moment plus për të arritur barabarësinë e kërkuar shumë vite. Ne do të japim mesazhe dhe do të bashkëbisedojmë me të gjithë qytetarët. Ne nuk do të bëjmë mitingje por do të zhvillojmë debate për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe halleve të shqiptarëve", theksoi Sela. Sipas tij, qëndrimet e ASH-së janë të njohura, por do të sqarohen se pse duhet që bashkë me ndryshimet e marrëveshjes së Prespës të bëhen edhe ndryshimet që kanë të bëjnë me barabarësinë dhe të drejtat e shqiptarët që i meritojnë, të arrihet barabarësia dhe jo koncepteve të shtetit një etnik. "Ne do ti bëjmë me dije qeverisë se ka alternativë ndaj krimit dhe korrupsionit dhe kjo është ndershmëria, rruga drejt BE dhe NATO. Duhet ta kuptojnë ata se NATO nuk është vetëm anëtarësim i vendit në një strukturë ushtarake, por është drejtësi dhe respektim i të drejtave elementare të njeriut, të largosh politikanë të korruptuar, duke shkelur të drejtat e popullit", theksoi Sela.

Shefja e shtabit qendror për fushatën, Bujare Abazi theksoi se ASH ka bërë të gjitha përgatitjet e

duhura, duke hapur 27 shtabe komunale dhe lokale. "Përmes debateve do ti shpjegojmë qytetarëve për benefitet që do të kemi për anëtarësimin e vendit në NATO dhe BE. ASH do të ketë fushatë pozitive me thirrjen për të mbështetur referendumin duke e pasur si shpresë integrimin e vendit në NATO dhe BE", theksoi Bujare Abazi.

Veçmas fushatën për referendumin e hapi të hënën edhe Lëvizja BESA. Shefi i shtabit zgjedhor të kësaj partie Arjanit Hoxha tha se në referendum me votën "për" për radhitemi në grupin e gjithë atyre që janë pro NATO-s dhe Bashkimit Evropian (BE) si alternative e vetme për Maqedoninë dhe të ardhme të sigurt të vendit. "Ne me votën "për radhitemi në grupin e gjithë atyre që janë pro NATO-s dhe Bashkimit Evropian (BE) si alternative e vetme për Maqedoninë dhe të ardhme të sigurt të vendit. Pasi që edhe referendumi edhe ndryshimet kushtetuese janë pjesë e po këtij procesi, por në dy faza të ndryshme, ne në fazën e parë do të motivojmë popullatën shqiptare që masovikisht të dalë me 30 shtator dhe të votojë për, ndërsa në fazën e dytë të ndryshimeve kushtetuese do të angazhohemi që komform përcaktimeve programore të kërkojmë saktësimin e termit kushtetues prej 20 për qind të zëvendësohet me shqiptarë dhe gjuhë shqipe", tha Arijanit Hoxha.

Moto e Lëvizjes BESA është: Po për NATO dhe BE, si shqiptar jo si përqindje".

## BDI MË AKTIVE NË FUSHATË

Nga partitë në pushtet BDI shihet më tepër aktive në fillimin e fushatës për referendumin. Të premtën ka mbajtur mbledhje shtabi qendror së bashku me kryetarët e 35 shtabeve lokale në të gjithë Maqedoninë. Shefi i shtabit qendror Atilla Rexhepi, siç informuan nga BDI, ka përcaktuar formimin e shtabeve për referendumin në të gjitha degët e BDI-së dhe u ka ndarë vendime shfaqje të zgjedhur të shtabeve komunale duke ju uruar atyre punë të suksesshme. Në takim u miratua edhe agjenda nga takimi i kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti me qytetarët, strategjia e veprimit në terren prej strukturave ndërsa është ndarë edhe platforma politike për referendumin e miratuar në seancën e Këshillit Qendror të BDI-së. Shtabi qendror i Bashkimit Demokratik për Integrim ka vlerësuar se më 30 shtator sillet vendimi për integrimin e vendit në NATO dhe BE, ndërsa takimet me qytetarët partia do t'i fillojnë nesër në Tetovë, dhe do t'i përfundojë në Shkup. PDSH ka njoftuar se do të fillojë fushatën për referendumin të hënën në pra 19:30 në Komunën e Çairit, në teatrin e fëmijëve në Çarshinë e vjetër në Shkup me moton: "Një hap para PËR NATO dhe BE",

Të premtën, siç citojnë nga partia, në mbledhjen e zgjeruar të Kryesisë Qendrore me kryetarët e degëve, u zgjodh shtabi zgjedhor, ndërsa gjatë fundjavës u mbajtën edhe mbledhjet në të gjitha degët dhe nëndegët e PDSH-së ku u formuan shtabet e degëve dhe u zgjodhën kryetarët dhe anëtarët e tyre. Shtabe janë formuar në Likovë, Kumanovë, Haračinë, Hasanbeg, Butel, Çair, Shuto-Orizare, Veles, Çashkë, Karshiakë, Sopshtë, Saraj, Zhelinë, Tearcë, Tetovë, Bërvenicë, Bogovinë, Negotinë-Vrapçisht, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Strugë, Ohër, Resnjë, Dollnen, Krushevë dhe Manastir.

## SHOQËRIA CIVILE: "EC PËRPARA! ZGJEDHJA ËSHTË E JOTJA",

Krahas partive politike edhe organizatat joqeveritare në mënyrë të organizuar do të zhvillojnë fushatë për referendumin e 30 shtatorit. Nën sloganin "Ec përpara! Zgjedhja është e jotja", organizatat qytetare bartëse të iniciativës, nëpërmjet të një sërë aktiviteteve publike dhe mediatiqe, do të tentojnë që qytetarëve t'ua afrojnë Bashkimin Evropian dhe politikën e saja, por edhe t'u përgjigjen pyetjeve lidhur me atë se çfarë duhet të bëjë Maqedonia në rrugën drejt BE-së dhe NATO-s dhe çfarë do të fitojë me integrimin euro-atlantik. "Vlerësojmë se në këtë moment duhet që të aktivizohet i të gjithë me qëllim që qytetarët të jenë të informuar. OJQ-të do t'i informojnë qytetarët për të gjitha fushatë nga këndvështrimi i anëtarësimi i Maqedonisë në BE dhe NATO, si në arsim, bujqësi, shëndetësi, sundim të ligjit, ekonomi etj", tha drejtoresha e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni, Fani Karanfillova Panovska.

Bartës të iniciativës qytetare janë: Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane, OJQ Infoqendër, Forumi Rinor Arsimor (FRA ose MOF), Civil – Qendra për Liri, ESE – Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave, Koalicioni Rural, Asociacioni për Edukim dhe Hulumtim Shëndetësor – HERA dhe Qendra për Arte Moderne. Nga partitë që janë kundër referendunit, VMRO DPMNE, sic mësohet se të martën pas mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv do të bëjë publik qëndrimin ndaj referendunit. Megjithatë nuk pritet për një bojkot të kësaj partie, pas qëndrimeve të forta të Kancelares gjermane Angela Merkel, dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg se me JO Maqedonia nuk alternative tjetër për në BE.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 10 shtator - Fushata për referendumin të hënën ka nisur zyrtarisht nga Parlamenti si bartës kryesor i këtij procesi. Por pjesën më atraktive të fushatës për referendumin pritet ta bëjnë partitë politike sidomos tek blloku politik shqiptar. Kjo për faktin se si BDI dhe dy subjektet tjera në pushtet, PDSH dhe grupi i Afrim Gashit të Lëvizjes BESA ashtu dhe dy partitë opozitare Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA do të dalin në terren për të kërkuar votën e elektoratit shqiptar pro Marrëveshjes për emrin me Greqinë në referendumin 3- shtatorit. Vetë fakti se partitë shqiptare kane formuar të gjitha shtabe qendrore dhe shtabe lokale flet për një përqëndrim të forcave partiake për të rritur ndikimin në elektoratin shqiptar, para zgjedhjeve presidenciale apo dhe zgjedhjeve të mundshme parlamentare në prill të vitit të ardhshëm kjo për shkak të rrethanave të reja politike që do të sjell referendumi për emrin.

## ASH ME KRITIKA NDAJ PARTIVE NË PUSHTET

ASH e Ziadin Selës hapjen e fushatës për referendumin ka nisur me kritika ndaj partive në pushtet. Kryetari Ziadin Sela tha se përveç integritetit në NATO dhe BE, Qeveri si alternativë të krimit dhe korrupsionit ka Aleancën dhe mrekullia e ASH-së është rruga drejt barazisë së plotë "Jepeni votën atje ku kemi bërë pjesë gjithmonë, bëhuni pjesë e NATO dhe BE. Aleanca është me Aleancën dhe mrekullia e ASH është rruga drejt barazisë së plotë", ishte porosia e kreut të Aleancës për Shqiptarët (ASH), Ziadin Sela.

## KOCIJANÇIQ : REFERENDUM PA NDËRHYRJE NGA JASHTË

Zëdhënësja e Komisionit Evropian (KE), Maja Kocijançiq sot nga Brukseli ka deklaruar se nga Maqedonia pret që votimi i qytetarëve në referendum të bëhet pa ndërhyrje nga jashtë shtetit. "BE-ja e ka përkrahur marrëveshjen e emrit, tash duhet të ndërmerren edhe hapa të tjerë që marrëveshja të jetë definitive. Referendumi është momenti ku populli mund të shfrytëzojë të drejtën demokratike, ky është moment i rëndësishëm për ata, që të vendosin për



ardhmërinë e shtetit, dhe duhet të ju mundësohet, që ta bëjnë pa ndërhyrje nga jashtë", tha Kocijançiq. Duke u përgjigjur pyetjes së gazetarëve, se KE-ja i ndihmon Maqedonisë që të luftojë lajmet e rreme nga faktorët e jashtëm për ndërhyrje në fushatë, Kocijançiq njoftoi se shërbimet evropiane i shpërndajnë praktikën më të mira në këtë fushë. Kocijançiq ka bërë të ditur se organizimi i referendunit është në duart e Maqedonisë, si shtet i pavarur.

# NATO: RUSIA PO BËHET MË AGRESIVE

BRUKSEL – NATO-ja deklaroi se stërvitja ushtarake e Rusisë Vostok-2018 që do të realizohet me pjesëmarrjen e 297 mijë ushtarëve më 11-17 shtator fokusohet në konflikte të përmasave të mëdha dhe se ajo përputhet me një formë më “agresive” të cilën Moskë e ka shfaqur së fundmi.

Në një deklaratë për AA, zëdhënësjë e NATO-s Oana Lungescu tha se të gjitha shtetet kanë të drejtë për të zhvilluar stërvitje me forcat e sigurisë, por kjo, sipas saj, është e rëndësishme të bëhet në mënyrë “transparente dhe të parashikueshme”.

Lungescu rikujtoi se në Këshillin NATO-Rusi të mbajtur nga zyrtarët në maj të këtij viti është diskutuar edhe Vostok-2018, ndërsa Moskë i ka informuar se stërvitja do të jetë shumë më e gjerë sesa Vostok-2014.

“Stërvitja Vostok fokusohet në konflikte të përmasave të mëdha. Kjo përputhet me një sjellje të



cilën e kemi parë kohëve të fundit. Është ajo e një Rusie më agresive që rrit buxhetin e mbrojtjes dhe praninë ushtarake”, tha Lungescu, duke theksuar se NATO-ja ndjek nga afër të gjitha stërvitjet ruse.

Ajo tërhoqi vëmendjen se Rusia ka shtuar në masë të konsiderueshme praninë ushtarake në rajonet e Detit Baltik, Detit të Zi dhe Mesdheut, ndërsa tha se Rusia

është e gatshme të përdorë forcë ushtarake ndaj fqinjëve të saj në vazhden e zhvillimeve në Ukrainë dhe Gjeorgji. Në stërvitjen Vostok-2018 do të marrin pjesë 297 mijë ushtarë të cilën ushtria ruse do ta kryejë nga 11 deri më 17 shtator në Siberi dhe lindje të vendit.

Pritet që në stërvitje të angazhohen më shumë se 80 avionë, helikopterë dhe mjete ajrore pa pi-

lot, rreth 36 mijë tanke dhe mjete të tjera të blinduara ushtarake, ndërkohë që marrin pjesë edhe njësitë ushtarake kineze dhe mongoliane.

Vostok-2018 është paraparë të jetë stërvitja ushtarake ruse me pjesëmarrjen më të lartë që nga stërvitja “Zapad-81” e realizuar në vitin 1981 gjatë periudhës së Bashkimit Sovjetik.



## Stoltenberg: Ska “jo” për marrëveshjen e “po” për NATO

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, i ka kërkuar Greqisë dhe Maqedonisë të ratifikojnë marrëveshjen që të dyja vendet arritën në muajin qershor për çështjen e emrit të Maqedonisë. Në një intervistë për Kathimerini, Stoltenberg tha se NATO nuk mund ta detyrojë asnjë vend të bëjë atë që nuk do, por gjithashtu shprehu besimin se marrëveshja do të zbatohet në të dy vendet. Është thelbësore për besueshmërinë kombëtare kur një vend nënshkruan një marrëveshje dhe pala tjetër garanton se dy palët do t'i përmbahen asaj. Çdo gjë tjetër do të minojë në mënyrë serioze besueshmërinë kombëtare të një vendi - tha Stoltenberg. Sipas Stoltenberg marrëveshja do të ratifikohet nga Maqedonia dhe Greqia në përputhje me afatet e parashikuara në dokument. ‘Kjo do të thotë se një gjë e tillë mund të ndodhë në fillim të vitit tjetër, – shtoi ai.

Në datën 30 shtator, në Maqedoni do të mbahet një referendum për ratifikimin e marrëveshjes, e cila parashikon që vendi do të marrë emrin e ri Maqedonia e Veriut. Shefi i NATO-s vuri në dukje se nëse marrëveshja nuk ratifikohet dhe Maqedonia nuk vijon me ndryshimet në kushtetutën e saj, ajo nuk do t'i bashkohet NATO-s. Stoltenberg gjithashtu shprehu sigurinë se Shkupi nuk do të tërhiqen nga angazhimet e tij pasi t'i bashkohet aleancës më të madhe ushtarake në botë. – Ajo çfarë kemi parë është se vendet i janë bashkuar NATO-s dhe Bashkimit Europian, kanë respektuar detyrimet e tyre, kanë përmbushur angazhimet e tyre, dhe jam plotësisht i sigurt se ky është gjithashtu një rast i tillë. Është në interesin e Shkupit dhe Athinës por edhe të gjithë Europës që dy vendet ta zgjidhin këtë çështje.



## Qeveritë fillojnë të zbatojnë pikat e marrëveshjes

Të hënë Qeveria greke dhe ajo Maqedonase kanë formuar Komitetin e përbashkët interdisciplinar i ekspertëve (KPIE) për çështje historike, arkeologjike dhe arsimore mes Maqedonisë dhe Greqisë. Në përbërjen e KPIE nga pala e Maqedonisë ka shtatë anëtarë, në krye me ambasadorin Viktor Gaber. Siç informoi të hënë Ministria e Punëve të Jashtme, ky komitet është formuar në pajtim me nenin 8 paragrafi 5 nga Marrëveshja përfundimtare mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, të nënshkruar më 17 qershor të vitit 2018 (Marrëveshja e Prespës).

## Ambasada e Rusisë përgënjeshton vetveten

Ambasada e Rusisë në Shkup ka deklaruar se publikimi i tyre në “Twitter” në lidhje me thirrjet e politikanëve të jashtëm për ta përkrahur referendumin në Maqedoni, ka pasur të bëjë me presidentin e Shqipërisë Ilir Meta dhe jo me të sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg si dhe kancelarët e Austrisë dhe Gjermanisë, Sebastian Kurc dhe Angela Merkel, të cilët para ca ditësh e vizituan Maqedoninë.

Në publikimin e tyre në Twitter, Ambasada

e Rusisë pyet se si do të ishin reagimet nëse politikanët nga Moskë do ta bënin atë që e bëjnë ata të perëndimit, edhe pse qytetarët në referendum nuk pyeten nëse do të integrohen në Rusi, por në BE dhe NATO.

“Këto ditë nuk është rrallë që liderët e huaj t’u sugjerojnë qytetarëve të Maqedonisë se si të votojnë në referendum. Interesante, si do të ishte nëse kësi lloj “këshilla” të shpërndajnë përfaqësuesit e Rusisë zyrtare?”, thuhet në publikimin e Ambasadës së Rusisë në Shkup.



## Mijalkov: Dëshmitë të publikohen në tërësi



Shkup, 10 shtator - Me publikimin e materialeve, sot, në Gjykatën Penale është zhvilluar seanca për rastin “Thesari” të Prokurorisë Speciale Publike (PSP), ku të akuzuar janë ish drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Sasho Mijalkov, shefi i kabinetit të tij, Toni Jakimovski dhe ish pjesëtarri i Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB), Nebosha Stankoviq.

Para fillimit të seancës së sotme gjyqësore, kryetarja e Këshillit Gjyqësor, Xheneta Bektoviq, ka njoftuar prokurorin përkatës të lëndës, se Toni Jakimovski ka dërruar

guar kërkesë për fshirje të aktgjyqimit fillestar.

I akuzuari Sasho Mijalkov nga gjykata ka kërkuar që dëshmitë të publikohen në tërësi, respektivisht të lexohet tërë përmbajtja e dëshmive, për arsye siç tha ai, t’i bëhet e qartë opinionit se për çfarë bëhet fjalë.

Për rastin e PSP-së, “Thesari”, janë dorëzuar 900 dëshmi materiale.

Në seancën paraprake, Këshilli Gjyqësor ka sjellë vendim që i akuzuari, Goran Grujoski të gjykohej në mungesë, pasi që

Gjykata Supreme në Athinë ka sjellë vendim kundër ekstradimit të të akuzuarit, duke e ndërprerë paraburgimin dhe lëshuar në liri.

Të akuzuarit në “Thesari” ngarkohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare, për autorizim dhe shkaktim të dëmit ndaj buxhetit shtetëror në vlerë prej 862,045 euro për furnizim të pajisjeve elektro-komunikuese për nevojat e Drejtorisë së Pestë në kuadër të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe trajnim të përdorimit të saj nga ndërmarrje në Britani të Madhe.

Fati i Prokurorisë Speciale Publike nëse do të bëhet pjesë e Prokurorisë Publike pritet të shqyrtohet gjatë në muajin tetor. Problemi kryesor se pse deri më sot nuk janë miratuar këto ndryshime qëndron në faktin se VMRO-DPMNE nuk ka pranuar të votoi këtë ligji sistemor për të cilin nevojiten 81 vota të deputetëve në Parlament

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 10 shtator - Procesi i reformave në gjyqësor do të vazhdojë në muajin tetor. Fushata dhe përgatitjet për referendumin sipas të gjitha gjasave janë shkaku kryesor sepse reformimi i sistemit të drejtësisë do të zvarritet. Për çështjen e këtyre reformave së fundmi është prononcuar edhe kryeministri Zoran Zaev, i cili thotë se miratimi i vendimeve që burojnë nga Këshilli për zbatimin e reformave në gjyqësor pritet të bëhet në muajin tetor. Pas aprovimit në qeveri pakoja e reformave në drejtësi, sipas Zaevit do të duhet të realizohet në praktikë.

"Me rëndësi është implementimi i vendimeve që i sjell Këshilli për reforma. Vlerësoj se zbatimin varet nga çdo individ në sistemin gjyqësor, duke filluar nga gjykatësit, prokurorët, punëtorët profesional, gjegjësisht transparencja dhe pavarësia është një prej hapa që presim të ndërmar çdo gjykatës apo prokuror me të vetmin qëllim krijimin e një gjyqësori të pavarur dhe të kontrolluar

## KTHIMI I BESIMIT NË DREJTËSI

# REFORMAT NË GJYQËSOR PAS REFERENDUMIT

nga ana e organeve shtetërore dhe sektorit civil", tha Zaevi.

Ai, njëkohësisht e ka bindur opinionin se reformat e ardhshme që do të ndodhin në masë të madhe do të kontribuojnë për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve në drejtësi. Gjatë periudhës së kaluar Parlamenti arriti të bëjë plotësim-ndryshim i disa ligjeve, mes të cilëve më të dalluara ishin ndryshimet e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, atë për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për gjykata. Megjithatë, përkundër apeleve dhe kërkesave që të miratohet ndryshimet e Ligjit për prokurorinë publike një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Pjesë e këtyre ndryshimeve sipas paralajmërimeve të Qeverisë është edhe përfshirja e Prokurorisë Speciale Publike, në kuadër të Prokurorisë Shtetërore. Procedimi dhe hetimet e korrupsionit në nivel të lartë janë vetëm një prej sferave që

PSP-ja do të përndjek pasi të bëhet pjesë e Prokurorisë Publike. Ndryshe, ditë më parë nën monitorimin e ministres së Drejtësisë, Renata Deskoska, në Qeveri u zhvillua mbledhje e pesë e Këshilli për zbatimin e Strategjisë për reforma në drejtësi (2017-2022). Në këtë mbledhje siç njoftojnë nga Qeveria prezantimin e tij para anëtarëve të Këshilli e ka pasur gjykatësi Dragomir Jordanov, ish drejtor i Akademisë bullgare të gjykatësve dhe prokurorëve. Duke folur për rekomandimet kyçe për misionin e trajnimit të gjykatësve, gjykatësi Jordanov ka theksuar se Akademia bullgare e gjykatësve dhe prokurorëve ka arritur të trajnon gjashtë gjenerata të gjykatësve dhe prokurorëve. Ndërkohë, ai ka shtuar se motoja e tyre ka qenë: "Drejtësia nuk mundet të jetë më e mirë se ata që e zbatojnë dhe se kriteri i vetëm gjatë punësimeve janë meritat".

Ministrja Deskoska, duke folur për çështjen e prokurorisë tha se janë duke u bërë përpjekje që gjykatësit në Prokurorisë Publike të transferohen, për shkak se për momentin aty mungojnë rreth 16 prokuror. Mbase problemi me Fakultet e shumta juridike në vendin tonë është evident, kësajsoj edhe numri i lartë i juristëve të diplomuar, gjykatësi Jordanov ka potencuar se e patjetërsueshme është planifikimi i resurseve njerëzore dhe gjithsesi, trajnimi i përbashkët i kandidatëve. Qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë është se ato disponojnë me evidencë të rregullt të numrit të Fakulteteve Juridike, me çka është konfirmuar se në Maqedoni ekzistojnë katër Fakultetet Juridike që funksionojnë në kuadër të Universiteteve Shtetërore, njëri prej të cilëve është pjesë e partneritetit publiko-privat dhe gjashtë tjerë në universitet private.

## Nga 1 janari 2019, punë në Gjermani edhe pa pasaportë evropiane



Nga 1 janari i vitit të ardhshëm hyn në fuqi Ligji i ri për punësimin në Gjermani, me të cilin të gjithë qytetarët e vendeve të ish-Jugosllavisë dhe Ballkanit Perëndimor mund të punojnë pa pasur pasaportë evropiane, sic është rasti me pasaportat bullgare që posedojnë shumë maqedonas, informon Balkan-life.com.

Aktualisht qytetarët e vendeve të paanëtarësuar mund të punojnë vetëm me një vizë pune, por kjo nuk do të vlejë nga fillimi i vitit të ardhshëm, shkruan INA.

Gjermanisë aktualisht po i mungojnë ekspertët apo punëtorët e kualifikuar dhe nga kjo ky vend i zhvilluar evropian po shënon humbje prej 30 miliardë euro në vit. Momentalisht Gjermania ka nevojë për 440 mijë punëtorë me kualifikime të larta apo ekspertë që janë të nevojshëm për shumë kompani gjermane.

Elektroindustri – 50 mijë inxhinierë  
Sektorin IT – 55 mijë ekspertë  
Industriinë e makinerisë 11 mijë si dhe në fusha tjera  
Mbi 60 % e kompanive gjermane thonë se kanë mungesë të kadrove të kualifikuar. Sipas parashikimeve, Gjermanisë në vitin 2030 do ti mungonin mbi 3 milionë punëtorë të kualifikuar.

## Shembja e "Kosmosit", Canoski fajëson Gruevskin dhe Janakieskin

Shkup, 10 shtator - Në Gjykatën Penale sot vazhdoi procedura e dëshmitëve për rastin e PSP-së "TNT" për rrënimin e kompleksit "Kosmos" të Fijat Canoskit pas zgjedhjeve të vitit 2011-të, përcjell Telegrafi Maqedoni. Në seancën e sotme gjyqësore u prezantuan dëshmitët nga një seancë mbikëqyrëse në Kuvend, në të cilën është diskutuar çështja e "Kosmos", si dhe dëshmuar edhe profesorët e

Fakultetit të Inxhinierisë.

Gjatë kohës së pauzës të gjykimit të sotëm, ish-kryetari i komunës së Gazi Babës, tani i paditur për rastin TNT, Toni Trajkovski tha se me këtë procedurë gjyqësore të pandehurit do të jenë në gjendje të demonstrojnë, siç tha ai, për 36 herë për të tregojnë se komuna e Gazi Babës dhe ai si kryetar komune i atëhershëm veproi ligjërisht. Canoski tha se pamjet e debatit par-

lamentar të paraqitura në seancën e sotme të gjyqit dhe bisedat e përgjuara në mënyrë të pafund tregojnë se prishja e objektit "Kosmos" u organizua nga kryeministri Nikolla Gruevski dhe ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakieski. Në pyetjen e gazetarëve nëse ai ndjehet i tradhtuar nga ish-partnerët e koalicionit, Canoski tha se Gruevski dëshironte të shkatërronte gjithë familjen e tij.

Për lëndën "TNT", Nikolla Gruevski, Mile Janakieski, Toni Trajkovski dhe tre inspektorë nga Gazi Babë akuzohen për shpërdorim të detyrës zyrtare dhe kompetencave, të cilët kanë "konfirmuar" devijimet e supozuara të ndërtimit. Sipas aktakuzës së PSP-së, të pandehurit në vitin 2011-të kryen veprën penale nga urretjtja politike duke shkatërruar kompleksin e Fijat Canoskit.

## Bekteshi takoi ambasadorin e Finlandës Pitter Ikonen

Shkup, 10 shtator - Ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi sot priti në takim pune ambasadorin e Finlandës z.Pertti Ikonen, me të cilin biseduan lidhur me bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira mes dy vendeve, dhe masat që duhen të ndërmerren në periudhën e ardhshme me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të dyanshëm, thuhet në komunikatën e kësaj Ministrie. Ambasadori Ikonen me këtë rast informoi Ministrin Bekte-



shi për interesin e shumë kompanive finlandeze për të bashkëpunuar me kompani nga Maqedonia, me theks të veçantë në fushën e buri-

meve minerale, ku në mënyrë indirekte janë të angazhuar rreth 50 vetë, falë sistemit dhe teknologjisë së lartë dhe profesionale që kanë. Ministri Bekteshi gjithashtu u informua edhe me Forumin e paralajmëruar ekonomik që do të mbahet më datë 04.10.2018 nën organizim të Ambasadës së Finlandës dhe Odës Ekonomike të Maqedonisë me temë "Doing business with Finland" me ç' rast u ftua të ketë dhe fjalë përsëritëse, duke shtuar se forumet e këtij niveli janë

mënyra më e mirë për njohjen dhe prezantimin e kompanive mes vete. Ministri Bekteshi nga ana tjetër, informoi bashkëbiseduesin e tij, me trendin ekonomik gjithnjë e më ngritje në vend, rritjen e prodhimit industrial, rritjen e eksporteve të vendit, që ka ndikuar edhe në rritjen e dukshme të Bruto Prodhimit Vendor në kuartalin e dytë dhe kjo falë përcaktimit të kësaj qeverie, për qasje miqësore ndaj të gjitha shteteve që duan të bashkëpunojnë me të.

VERIFIKIMI I DIJEVE TË NXËNËSVE

# MEKANIZËM QË SIGURON CILËSI – I DOMOSDOSHËM

MASH është duke punuar në gjetjen e mekanizmave të ri për të vlerësuar cilësinë e arsimit, mirëpo ende nuk ka diçka konkrete. Nga MASH deklaruan se edhe nëse do të ketë testim ,nuk do të ndikojë në suksesin e nxënësve dhe pagën e mësimdhënësve



veni dhe do të merret si model në Maqedoni. Ndërkaq testimi do të kryhet nga Qendra e Provimit Shtetëror ku ekziston komision që ka program pune.

Mirëpo nga MASH për Gazetën Koha hedhin poshtë idenë e një testimi nacional. Ata deklaruan se ende nuk kanë diçka konkrete rreth kësaj, mirëpo janë në bisedime me drejtoritë dhe institucionet përkatëse dhe gjithçka është në nivel të ideve. MASH janë të mendimit se duhet të ketë një mekanizëm mbi kontrollin e cilësisë së arsimit i cili në radhë të parë do të shërbejë MASH për të pasur një pasqyrë reale ku jemi dhe çfarë duhet të bëjmë për ta ndryshuar këtë cilësi.

“Nuk kemi asgjë konkrete lidhur me zëvendësimin e testimit ekstern . Kemi modele nga vende të ndryshme si Sllovenia, Estonia ,Gjermania të cilat i kemi parasysh

sepe kanë treguar rezultate mjaft pozitive dhe të suksesshme në procesin e arsimit, mirëpo gjithçka mbetet në kuadër të bisedimeve dhe ideve që jepen. Nëse vendoset të merret për bazë një nga modellet të cilat po bisedohen do të organizohen debate publike të ndryshme në mes institucioneve, profesorëve, qendrave përkatëse ,shkollave të cilët do të japin mendimin e tyre dhe bashkërisht do të vendosim”, thonë nga MASH.

Në mënyrë të veçantë nga MASH potencuan se rezultatet në asnjë mënyrë nuk do të ndikojnë tek nxënësit dhe mësimdhënësit, sepse asnjë lloj testimi nuk duhet të merret si kërcënim në të kundërtën nuk do të kemi efektin e duhur, mirëpo do të arrihet kundër efekt ashtu siç ishte me testimin ekstern.

Ndërkaq nga Sindikata e Arsimit , Shkencës dhe Kulturës (SA-

SHK) të cilët më parë kishin propozuar që në vend të një provimi në vit, të ketë provim në çdo tremujor për të marrë një pamje më reale të arritjeve të nxënësve dhe rezultateve të mësimdhënësve ,mirëpo propozimi i tyre nuk kishte kaluar. Për Gazetën Koha nga SASHK deklaruan se janë të gatshëm të marrin pjesë ne grupet e punës mirëpo gjithmonë duke pasur parasysh që ti mbrojnë interesat e mësimdhënësve.

“Kemi pasur disa takime me Ministrin Ademi ku kemi diskutuar rreth reformave në arsim dhe implementimin e tyre, mirëpo sa i përket se a po përgatitet ndonjë testim ne nuk kemi njohuri. Presim të jemi të kyçur dhe të ndihmojmë në çfarëdo lloj procesi në arsim sepse kemi përvojë, por mbi gjitha për ne është primare të mbrojmë edhe interesin e mësimdhënësve që ata të mos jenë të

dëmtuar”, thanë nga SASHK

Testimi ekstern vitin e kaluar u ndërpre nga ish ministra e Arsimit dhe Shkencës Renata Deskoska. Ky testim ishte pjesë e reformave të qeverisë së kaluar dhe u realizua gjashtë vite me radhë në arsimin fillor dhe të mesëm .Ky testim u bë me qëllim të verifikimit dhe vlerësimit të notave të vendosura nga ana e mësimdhënësve , nëse ishin të merituar apo jo. Reagimet ishin të shumta si nga ana e mësimdhënësve por edhe nga ana e nxënësve ,sepse sipas tyre me një test nuk mund të vlerësohet notimi i nxënësve. Ishin paraparë edhe shpërblime dhe ndëshkime për mësimdhënësit mirëpo të cilat në praktikë nuk ishin dënuar.

Ky vit filloi pa reformat e paralajmëruar dhe sigurisht që një testim i tilli nuk do të jetë pjesë e këtij viti shkollorë, që u konfirmuan edhe nga MASH .

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 10 shtator – Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) po punon vazhdimisht për të përgatitur një test të ri i cili do të paraqesë mekanizëm për kontrollimin e nivelit dhe cilësisë arsimore të nxënësve .

Në bazë të zëvendës ministrit të MASH, Petar Atanasov i cili për portalin deca.mk pak ditë më parë kishte deklaruar se do të ketë një të ashtuquajtur testim nacional, ku nxënësit do të testohen dy herë gjatë arsimit fillore. Një testim duhet të kryhet në klasën e katërt dhe tjetri në klasën e nëntë. Ky është model që aplikohet në Sllo-

Ministri Filipçe ka deklaruar se janë siguruar disa ilaçe të reja të cilët deri tani aspak nuk ishin të pranishme në vendin tonë, me ç’rast ka përfunduar edhe regjistri elektronik për sëmundje të rralla dhe tani në çdo moment dihet sasia e ilaçeve të disponueshme

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 10 shtator – Organizatat joqeveritare kanë kërkuar që të sigurohen ilaçe për terapitë e pacientëve me sëmundje të rralla. Në listën e ilaçeve tu shtohen edhe disa të tjera të nevojshme për këtë kategori njerëzish. Nga shoqata “Jetë me Sfidë” thonë se ka nevojë për ilaçe të tjera, përpos atyre ekzistuese, për pacientë të regjistruar të rinj dhe për ilaçe të reja siç janë fibroza pulmonale, artritisia juvenil, ilaçe biologjike për sëmundje të rralla (por edhe të shpeshta) autoi-

TRAJTIMI I SËMUNDJEVE TË RRALLA

## FOND I VEÇANTË PËR ILAÇE TË TJERA



mune reumatologjike, pastaj edhe për Dushene dhe Beker distrofi muskulatore ku edhe nuk janë në dispozicion si ilaçe ekzistuese.

Përveç pacientëve, sëmundjet e rralla janë edhe një ngarkesë shtesë për familjet e tyre. Të dy palët presin që të përgatitet lista e ilaçeve inovative. Poashtu, për regjistrin elektronik për sëmundje të rralla, për shumë pacientë mbetet dilemë regjistrimi.

Ministria e Shëndetësisë thotë se para një viti ka iniciuar aktivitetet për t’i përkushtuar vëmendje më të madhe personave të prekur nga

sëmundje të rralla përmes ekspertizës së përmirësuar, vendosjes së procedurave të reja diagnostifikuese, furnizimin e ilaçeve të reja, përpunimin e regjistrit të sëmundjeve të rralla.

“Një pjesë të punëve i kemi përfunduar, tek një pjesë e punëve ende po punojmë dhe gjatë vitit të ardhshëm edhe më shumë do të arrijmë. Vendosëm disa ilaçe të reja të cilët deri tani aspak nuk ishin të pranishme në vendin tonë, e përfunduar regjistrin elektronik për sëmundje të rralla dhe tani jemi të aftë që çdo moment të dimë se me

çfarë sasi të ilaçeve disponojmë, ku ndodhen dhe se sa sasi të përkruhet”, deklaroi ministri Filipçe. Sipas tij së bashku me FSSHM dhe Ministrinë e Financave është biseduar për buxhetet për vitin e ardhshëm, ndërsa një prej prioriteteve ka qenë edhe për buxhetin për sëmundje të rralla. Shoqata e qytetarëve me sëmundje të rralla “Jetë me sfida”, këtë vit, ka realizuar disa aktivitete kushtuar personave të sëmurë nga sindroma Alport, sëmundje e rrallë e veshkave tek popullata e re, me qëllim që t’u mundësohet pacientëve dhe familjeve të tyre t’i ndajnë rrëfimet e tyre me ekspertët, të parashirojnë pyetje, ta kuptojnë diagnozën e tyre dhe aktivisht të inkuadrohen në studimet eksperimentale për zbulim të ilaçit të shumëpritur për sindromën Alport.

Viteve të fundit ka më shumë informata për sindromën Alport, por ende po ndodh që gabimisht të diagnostikohet ose të mos fitohet diagnozë. Mesatarisht pacientët presin edhe deri në dy vite

për diagnozë, që është tejet e rëndësishme nga atje që veshkat tek këta persona e humbin funksionin që para se të manifestojnë simptome të tjera.

Nga shoqata shtojnë se nuk ka trajtim që është treguar efektiv në pengimin e humbjes së funksionit të veshkave tek njerëzit me sindromën Alport, por ka disa ilaçe të cilat mund ta anulojnë ose ngadalësojnë avancimin e sëmundjes në qoftë se fillohet herët me terapi. Tani për tani nuk ka të dhëna të sakta për numrin e personave me sindromën Alport në Maqedoni, sipas vlerësimeve numri i tyre është diku mes 50 dhe 100 personave. Por, statistikisht flasin se mbi 450 persona në Maqedoni janë të prekur nga sëmundje të rralla, të ndryshme. Bëhet fjalë për 40 diagnoza, ose 80 diagnoza bazë, për 18 diagnoza blihen 30 ilaçe të ndryshme. Ndërsa, vetëm tre pacientë me sëmundje të rralla trajtohen në llogari të shtetit, edhe pse vetëm në shoqatën për sëmundje të rralla, “Jeta me sfida” ka 60 prej tyre.

Maqedonia e ka patjetër të bëjë harmonizimin e rregullativës dhe direktivave më BE-në dhe deri në fund të vitit 2019 duhet të ketë ligj të ri që nënkupton bashkimin e kartonit të gjelbër me polisën e sigurimit për auto përgjegjësi ku njëherit paralajmërohen dhe ndryshime në çmimin e kartonit të gjelbër gjegjësisht liberalizmin e çmimit të polisës për auto përgjegjësi

KËRKOHEN RISI NË LIGJIN PËR SIGURIM TË MAKINAVE

# ME REGJISTRIM TË VETURËS, KARTONI I GJELBËR I DETYRUESHËM



për dhënien e kartonit të gjelbër dhe kjo nuk paraqet premi për kartonin e gjelbër. Prandaj dhe çmimi për polisën e auto përgjegjësi është shumë më e lartë se në Maqedoni. Për shembull në Mal të Zi është 125 euro ndërsa në Maqedoni për makina është 80 euro mirëpo kur blihet dhe kartoni i gjelbër atëherë i bie që çmimi të jetë i njëjtë si në Mal të Zi", thotë Poposki. Ndërkohë sa i përket çështjes se do të ketë ndryshim të çmimit nëse do të liberalizohet tregu Poposki thotë se në bazë të përvojave të vendeve që kanë liberalizuar tregun si Kroacia, Bullgaria dhe Rumunia mesatarisht çmimi kishite trend të rënies e cila zgjati plot pesë vite, por kompanitë e sigurimeve konstatuan se nuk mund të paguajnë rregullisht dëmet e shkaktuara nga aksidentet në trafik sepse nuk kishin kapital të mjaftueshëm për të paguar dëmet. "Kompanitë e kanë patjetër të dekapitalizohen dhe të korrigjojnë çmimet. Për shembull në Bullgari çmimet janë rritur për 30 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Tani për tani nuk dihet saktë se çfarë koncepti do të zbatohet por mund të ndodhë të mos ketë ndryshime të çmimit në tregun e sigurimeve në Maqedoni. Rritja mund të jetë përqindje e vogël për makinat me vëllim të vogël të motorit ndërsa rritje mund të ketë për makinat me vëllim më të madh të motorit. Sa cili model do jetë i pranishëm ketë do ta dimë pasi Qeve-

ria të bëjnë analizat", thotë Poposki.

Poposki më tej shprehet se nuk ka kornizë kohore se kur Qeveria do të përcaktohet për miratimin e ligjit të ri por se ata si rregullator dhe industria e sigurimeve janë të gatshëm. "Që të ndodhë kjo shumë shpejt duhet patjetër të zgjidhet disa probleme aktuale si për shembull tolerancë zero për makinat e pa regjistruara, të mos ketë lëshime me vonesat e skadimit të regjistrimit të makinave si dhe të zgjidhet problemi për pagesën e dëmeve kur për të njëjtin aksident të ketë vendime gjyqësore të ndryshme", thotë Poposki. Me eliminim e këtyre problemeve në njëfarë mënyrë dukshëm do të ndikon që shoqatat të pranojnë bashkimin e polisës për auto përgjegjësi me kartonin e gjelbër dhe kjo aspak të mos ndikon në ndryshimin e çmimit dhe kjo të jetë në suaza të mundësive financiare të qytetarëve. "Qëndrimi i Agjencisë për supervisim të sigurimeve është që së pari të ndodhë bashkimi i polisës për auto përgjegjësi me kartonin e gjelbër dhe më pas të ndodhë dhe liberalizmi çmimesh në tregun e sigurimeve. Analizat tona rezultojnë se gjithë ky proces mund të ndodhë brenda dy viteve nëse Qeveria miraton vendimin për bashkimin i polisës për auto përgjegjësi me kartonin e gjelbër" thotë Klime Popovski kryetar i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për supervisim të sigurimeve.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 10 shtator—Nga janari i vitit 2020 të gjithë pronarët e makinave që do të duhet t'i regjistrojnë e kanë të domosdoshëm me regjistrimin e veturës së bashku me polisën për auto përgjegjësi të paguajnë edhe kartonin e gjelbër. Kështu thotë Klime Poposki kryetar i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për supervisim të sigurimeve. Sipas Poposkit Maqedonia e ka patjetër të bëjë harmonizimin e rregullativës dhe direktivave më BE-në dhe deri në fund të vitit 2019 duhet të ketë ligj të ri që nënkupton bashkimin e kartonit të gjelbër me polisën e sigurimit për auto përgjegjësi ku njëherit paralajmërohen dhe ndryshime në çmimin e kartonit të gjelbër gjegjësisht liberalizmin e çmimit të polisës për auto përgjegjësi.

legjislativen Evropiane. Kemi të bëjmë me një rregullativën revolucionare sepse po rritet kërkesat e shoqatave të sigurimit në pjesën e menaxhimit më efikas me rreziket, po rritet niveli i kapitalit të nevojshëm, rritet niveli i transparencës dhe përforcohet menaxhimi korporativ. Vetëm se e kemi të gatshme rregullativën në draft versionin dhe se duhet të fillojmë dialogun me industrinë e sigurimeve dhe se bashku të bëhemi gati për zbatimin dhe miratimin e ligjit të ri për sigurime. Në pajtim me programin nacional për harmonizimin e ligjit me legjislativen e BE-së deri në fund të vitit 2019 duhet të merr dritë jeshile dhe nga janari i vitit 2020 të fillohet me zbatim", thotë Popovski.

Gjithashtu ai thotë se ajo që duhet është të harmonizohet ligji me legjislativen Evropiane dhe kartoni i gjelbër mos të lëshohet ndaras por kjo të shkon së bashku apo të jetë pjesë e pandarë e poli-

sëd për auto përgjegjësi që do të thotë që çdo makinë që do të regjistrohet nga vitit 2020 do të duhet patjetër të paguajnë edhe për kartonin e gjelbër dhe me rëndësi-shmja e këtij ligji të ri është se do të liberalizohet tregu në formimin e lirë të çmimesh për auto përgjegjësi nga vetë shoqatat e sigurimeve. "Maqedonia ka çmime të rregulluara për polisën e auto përgjegjësisë të detyrueshme dhe kjo e bënë shtetin e vetëm në rajon dhe BE që zbaton politikën ndaras për polisën dhe kartonin e gjelbër prandaj dhe kemi një huti nga ana e qytetarëve rreth konceptit të kartonit të gjelbër. Në vendet e BE-së dhe në Serbi, Mal të Zi, Bosnja dhe Hercegovina përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, kartoni i gjelbër nuk paraqitet si polisë e veçantë por është përfshirë në çmimin e polisës për auto përgjegjësi gjatë regjistrimit të makinave. Kështu që në këto vende bëhet pagesë plotësuese prej 5 deri më 20 euro

PUNËTORËT E HUAJ NË MAQEDONI

## TURQIT NË VENDIN E PARË

Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 10 shtator— Punëtorët nga Turqia dominojnë në listën e punëtorëve të profileve të ndryshme të cilët të pajisur me dokumentacion të rregullt punojnë në Maqedoni. Sipas të dhënave të Agjencisë së punësimit të Maqedonisë, në vitin 2017 në tregun e punës në vend kanë qenë të punësuar 1037 punëtorë me shtetësi turke. Në vendin e dytë me 427 punëtorë renditet Serbia, ndërsa në vendin e tretë me 317 punëtorë renditet Greqia. Në totalin e punëtorëve të angazhuar nga jashtë dominojnë punëtorët nga shtetet e rajonit. Gjithnjë sipas statistikës zyrtare, nga Kosova me punë të përkohshme në Maqedoni në vitin e kaluar kanë qenë të punësuar

244 punëtorë, nga Shqipëria-196 punëtorë, nga Bullgaria-152 punëtorë dhe nga Bosnje e Hercegovina - 144 punëtorë. Më pak se 100 punëtorë janë angazhuar nga shtetet e tjera. Nga Kroacia në vitin 2017, në shtet kanë punuar 94 punëtorë, nga Gjermania kanë punuar 81 punëtorë dhe nga Ukraina -72 punëtorë.

Të huajt vijnë për punë në Maqedoni si drejtorë, punëtorë të thjeshtë, futbollistë, hendbollistë, mjekë specialistë, profesorë universitar dhe profesorë në shkollat e mesme, punonjës administrativë, por edhe kuadër i specializuar në fabrikat e investitorëve të huaj që mungojnë në tregun vendor të punës. Sipas Agjencisë së punësimit, gati gjysma apo afër 2000 punëtorëve të huaj janë

me shkollë të mesme apo me shkollë fillore. Statistika zyrtare tregon se me shkollë të mesme janë 1544 punëtorë, ndërsa pa arsim fillor janë 400 punëtorë. Nga ana tjetër, me shkollë të ndryshme të shkollimit të lartë, profesional, apo të specializuar janë të angazhuar afër 1600 persona. Me cikël të tretë të studimeve të doktoraturës janë të angazhuar 42 persona, me master janë angazhuar 50 persona, me ciklin e dytë të studimeve specialistike kanë punuar 77 persona, e kështu me radhë.

Numri relativisht i madh i të huajve që punësohen në Maqedoni i detyrohet rritjes së investimeve që vijnë nga këto shtete, si dhe lehtësimit të procedurave administrative. Një pjesë bukur e

mirë e drejtuesve të kompanive të huaja në Maqedoni në sektorë të ndryshëm, në strukturat udhëheqëse të larta apo të mesme kanë menaxherë të huaj. Nga ana tjetër, fabrikat e huaja në zonat e lira ekonomike ku dominon industria automobilistike, minierat, telekomunikacioni, teknologjia informatike, ndërtimi, tregtia, bankat, spitalet, qendrat distributive apo shpërndarëse, shkollat e mesme, fakultetet apo universitetet, janë vetëm një pjesë e sektorëve ekonomik ku kanë gjetur interesimin investitorët e huaj për të investuar në Maqedoni, dhe ku kanë angazhuar edhe fuqi punëtorë nga jashtë. Në ndërkohë, nuk janë të pakët në numër edhe punëtorët nga Kosova dhe Shqipëria që

punojnë në Maqedoni. Biznesi nga Kosova dhe Shqipëria, përveç në shoqëritë e sigurimeve, hapjen e qendrave tregtare nga ana e kompanisë ETC në Gostivar dhe Shtip, ka investuar edhe në qendrën tregtare Siti Moll, si dhe në ndërtimin e banesave, ndërsa janë të angazhuara edhe në ndërtimin e aksit rrugor Kërçovë-Ohër dhe objekte të tjera infrastrukturore. Me blerjen e Panairit të Shkupit nga ana kompanisë Balfin, ku parashikohet ndërtimi i një kompleksi gjigand afarist dhe banesor, mund të pritët angazhimi i mëtejshëm i fuqisë punëtorë nga Shqipëria. Gjithashtu, afaristët nga Kosova kanë hapur edhe më shumë fura për të cilat kanë angazhuar fuqi punëtorë nga jashtë.

Ndryshe, sipas qyteteve në Shkup janë të angazhuar 3297 punëtorë të huaj, në Koçanë 31, në Manastir dhe Shtip nga 26, në Tetovë-20, në Strugë-19, në Ohër-18 etj.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

**SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 174/2018**

për punësimin e 13 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B01000 Këshilltar për menaxhim, përpunim dhe analizim të të dhënave nga regjistri i ministrisë, Njësia rajonale Kumanovë, Sektori për organizim dhe koordinim të njësive rajonale

1 realizues(ë)

- Të jetë i moshës madhore,  
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,  
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkenca organizuese dhe menaxhim(menaxhment), Komunikim afarist  
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij  
- mësim dhe zhvillim  
- komunikim  
- arritje të rezultateve  
- puna me të tjerë/puna ekipore  
- ndërgjegjësimit strategjik  
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe  
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë  
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte  
- Orët javore të punës 40  
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30  
Rroga neto: 25.137,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

4. UPR0101V02000 Bashkëpunëtor i lartë për grumbullim, klasifikim dhe kontroll administrative të të dhënave nga regjistri i ministrisë, Njësia rajonale Probishtip, Sektori për organizim dhe koordinim të njësive rajonale

1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,  
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,  
- Të jetë i moshës madhore,  
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,  
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Pylltari dhe hortikulturë, Shkenca organizuese dhe menaxhim (menaxhment)  
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij  
- mësim dhe zhvillim  
- komunikim  
- arritje të rezultateve  
- puna me të tjerë/puna ekipore  
- ndërgjegjësimit strategjik  
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe  
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë  
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte  
- Orët javore të punës 40  
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30  
Rroga neto: 23.362,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.

5. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për punë operative në regjistrin e ministrisë, Njësia rajonale Kisella Vodë, Sektori për organizim dhe koordinim të njësive rajonale

1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,  
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,  
- Të jetë i moshës madhore,  
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,  
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Prodhimtari bimore, Vreshtari, Pemëtar  
- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij  
- mësim dhe zhvillim  
- komunikim  
- arritje të rezultateve  
- puna me të tjerë/puna ekipore  
- ndërgjegjësimit strategjik  
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe  
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë  
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte  
- Orët javore të punës 40

- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30  
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi në mes orës 15:30 dhe 16:30  
Rroga neto: 21.080,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

6. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për punë operative në regjistrin e ministrisë, Njësia rajonale Vallandovë, Sektori për organizim dhe koordinim të njësive rajonale

1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,  
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,  
- Të jetë i moshës madhore,  
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,  
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike, shkenca juridike  
- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij  
- mësim dhe zhvillim  
- komunikim  
- arritje të rezultateve  
- puna me të tjerë/puna ekipore  
- ndërgjegjësimit strategjik  
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe  
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë  
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte  
- Orët javore të punës 40

- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30  
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi në mes orës 15:30 dhe 16:30  
Rroga neto: 21.080,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

7. UPR0101V02000 Bashkëpunëtor i lartë për grumbullim, klasifikim dhe kontroll administrative të të dhënave nga regjistri i ministrisë, Njësia rajonale Gostivar, Sektori për organizim dhe koordinim të njësive rajonale

1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,  
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,  
- Të jetë i moshës madhore,  
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,  
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Prodhimtari blegtorale (blegtori)  
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme:**


- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij





# Vizita e Vuçiqit dhe impotentca e Thaçit dhe Jasharëve

Nga  
Valon A. SYLA



Mjaftoi një vizitë e Presidentit dhe Kryenegociatorit serb Aleksandar Vuçiq, që ne skenën politike të vendit të shfaqen 4 palë variante simultante kundërthënëse të qëndrimit kosovar, para një Serbie që duket më unike.

Çfarë loje brilante e nisur nga Presidenti Hashim Thaçi, përfundoi me një humbje vendimtare diplomatike. Duke nxitur përsëri vëmendje të hatashme vendore e ndërkombëtare kah vetja, përfundoi në një debakël diplomatik, i shkaktuar lehtësisht nga një plan i thjeshtë taktik i Aleksandër Vucicit.

Serbit të dalë mode që ende nuk di t'i zhveshë teshat e Yumco's së Vrajës, i mjaftoi vetëm një kërkesë provokuese për vizitë në Drenicë, për të shfaqur impotencën e 'Pashallëkut të Thaçit', servilitetit të pakoordinuar të Qeverisë, injorancën ambicioze të Jasharëve, dhe opozitën e kastruar e demobilizuar, pjesërisht nga sëmundja e liderit të saj Isa Mustafa e po aq nga dogmatizmi ideologjik komunist i social-media-kracisë demokratike të Shpend Ahmetit dhe Albin Kurtit.

## 1. Pashallëku i Hashim Thaçit

Loja dhe tendenca diplomatike e Hashim Thaçit që e nisi nga fillimi i gushtit, për oferta jashtë formatit të deritashëm të zakonshëm me Serbinë, pra ku flitet edhe për territore dhe përmirësime kufijsh, do të konsiderohej brilante nëse do të përfundonte me sukses, me diplomaci unikuese dhe unikconceptuale, sot para vizitës së Presidentit Vuciq.

Por, kjo dështoi pikërisht për shkak të sjelljes prej autokrati dhe vetjaku, që të çon mallin e një Pashë nga Hashim Thaçi, i cili tash e disa herë, komplet skenën politike e lë në terr informativ, të pa kordinuar, dhe me arrogancë... pastaj, kërkon mbështetjen e saj, e cila po shihet se më nuk po e përcjellë ashtu si dikur.

Këtë e tregojnë edhe numrat e koalicionit që rrjedh nga ai në parlament, që si afrohen më as shumicës së thjeshtë prej 61 deputetësh. Mos të flasim që oferta e tij diplomatike dhe diskursi i tij i fundit, për territore dhe zgjidhje perfundimtare me Serbinë, gjithsesi i nevojitet një mbështetje parlamentare prej 80 votave, e po ashtu çfardo marrëveshje tjetër që do ta sjellte kryenegociatori kosovar nga bisedimet në Bruksel.

Por jo, u tregua impotentë para Brukselit dhe diplomacie kompetente, që kosovarët asnjë agjendë për

vizitë zyrtare nuk mund ta sigurojnë në Jug të Ibrit, e sidomos në Drenicë prej nga vjen Kryenegociatori se lere më në Veri te Ujmani/Gazivoda. Sot Presidenti Thaçi, mas gjithë e kësaj zavërrzllame, shkruan statusa nga bregdeti shqiptar, i shoqëruar nga një President tjetër me tipare Pashe si Ilir Meta... duke ndejtur pikë në gadishmëri për ta emëruar fajtorin e radhës, që natyrisht se kurrë nuk është ai. Kjo për Presidentin tonë të pagabuar duket se është gjithmonë e pamundur, edhe pse prej kërshëndellave të kaluara dhe filmat kundër tribunalit e deri te kjo e fundit me Vucicin, s'po i dhezin në fund.

2. Qeveria Servile e Pashallëkut Kryeministri Ramush Haradinaj ka vendosur të mos përzihet në punët e politikës së jashtme, përveç kur i vjen radha të emëroj ndonjë Ambasador, ashtu siç vjen edhe radha sipas ndarjes së pushtetit me shokët e luftës me shumë zëvendëministra, dhe numra të trefishtë të veteranëve. Ka qasje servile se për këtë kujdeset tash Ministri i Thaçit në Qeverinë e Kosovës, Z. Behgjet Pacolli. Ai kujdeset që agjenda fillimisht për punët e Brukselit të kryhet vetëm nëpërmes Thaçit dhe të Implementohet nga Ministrat e AKR'së

në Ministrinë e Jashtme dhe të Brendshme të cilat dihet se dirigjohen nga Thaçi, e që mandati i kësaj qeverie shkoi duke u arsyetuar kishe edhe Haradinaj, Limaj e Pacolli, kanë kompetenca e hise aty.

Për ambasadat e huaja dihet për ndikimin e fortë kur thirrin me telefon, e disa edhe bërtasin, kur atyre duhet pranuar herë kërkesat Vucicit e herë të Thaçit, lidhur me agjendat e Brukselit, që kjo Qeveri shihet se ende nuk i di, sepse janë tepër sekrete, dhe duket se për ta mjafton t'i dijë Thaçi, bashkë me Mogherinin e Vucicin për të cilët në byfetë dhe korridorët e kësaj qeverie servile, flitet se do të bëhen njerëz të paqes së ardhshme historike.

Fundja për këtë Qeveri Servile edhe nëse dështon dikush si sot në diplomaci, i bjen se ka deshtuar Thaçi. Sepse ata janë aty vetëm për punë nga orët e hershme të mëngjezit, rroga dhe asfaltit.

3. Komandantat e Zonave dhe Jasharajt

Përveç serbëve të Kosovës, që qesin barikada në asfalt në shekullin 21, është edhe një klasë politike që e bënë të njejtën. Këta janë "Komandantat e Pavarur të Kosovës", nga Komuna e Skenderajt dhe gjetiu, ose

**Nuk mundesh të jesh brilant në diplomaci me Serbinë, nëse udhëheqësi Pashë impotent, ashtu siç sillet Presidenti Thaçi, që i mungojnë numrat në parlament, impotencë në qeverisje, siguri, e sidomos mos koordinim dhe dëgjim i komandantave të zonave. Sidomos atyre të Jasharëve.**



pasardhësit e tyre, të cilët as nuk janë me Thaçin, as me Veselin. As nuk janë me Qeveri e as me opozitë. Bile as me Albin Kurtin. Ata thonë se janë me popullin.

Kjo klasë politike është e veçantë dhe me traditë që shfaqet duke mos i zbritur Xhipit Range Rover dhe shilteve kur ulen këmbëkryq nëpër oda tradicionale, por që kanë edhe me mikrofna e zërim elektrik. Herë i sheh duke kcyer qyqek nëpër salla dasmashe, të stërmbushur me meshkuj e aty këtu me ndonjë hoxhë... e herë duke pozuar me musteqe kreshniku, çaj rusi e çiftelia, diku në oda, duke imituar fotografitë e Marubit, me malësorë të fundshekullit XIX.

Por, kjo bëhet vetëm për foto dhe propagandë elektorale dhe për Facebook, sepse shumica prej kësaj klase, ka një jetë paralele në banesa luksoze e moderne në lagje të Prishtinës, ku jetojnë jetë të dyfishtë, në raste speciale edhe me dashnore, që kanë qef t'i quajnë 'shvalerka' si komunistat jugosllavë.

Kur vjen rasti patriotik, ata kthehen në vendlindje, në kullat e ndërtuara rishtaz. Nëse guajnë me allti, për dritare me xhama të kaltëruar, edhe mund të bëhesh Zv. Ministër, e ndoshta edhe Zv. Kryeministër,

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovajsa lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 10 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772





## BRITANIKËT REALIZOJNË DOKUMENTAR TË ANIMUAR PËR SKËNDERBEUN

Një dokumentar i ri për Skënderbeun është publikuar këtë javë në kanal më të madh të video-materialeve në "Youtube".

Është kompania britanike e filmave të animuar "Kings And Generals", e cila ka realizuar një dokumentar për heroin e shqiptarëve dhe për rezistencën ndaj sundimit otoman. Dokumentari i animuar flet jo vetëm për betejat, për luftërat dhe për diplomacinë e Gjergj Kastriot-Skënderbeut, por edhe për detaje të njohura të jetës së heroit të shqiptarëve.

Edhe pse dokumentari është publikuar më 2 shtator dhe për pesë ditë në kanal zyrtar të "Kings and Generals", në "YouTube", ka arritur mbi 170 mijë shikime dhe mbi 7 mijë pëlqime.

Animacioni është një nga teknikat që zgjedh kjo kompani kinematografike në Britani për t'i afuar të rinjtë dhe fëmijët me historinë dhe për t'i bërë më



të njohura ngjarjet më të rëndësishme në botë.

Kujtojmë së këtë vit figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ka shënuar një përvjetor të rëndësishëm, atë të 550-

vjetorit të vdekjes së tij. Për këtë arsye ai këtë vit ka qenë element kryesor i shumë festivaleve kulturore e filmike, pjesë e ekspozitave të artit dhe të promovimit të librave.

## "Qytetërimi osman" në shqip

Vepra "Qytetërimi osman" në vështrim të parë, tek e merr në dorë, në dy vëllime, ka rëndësi në përmbajtje, siç ka dhe peshë në kuptimin e fjalëpërfjalshëm.

Botimi ka mbyllur një cikël të gjatë përpjekjesh për të ardhur gjer këtu, mbi tre vite e gjysmë punë në përkthim nga anglishtja e përgatitje për shtyp. Ndërkohë, cilësia e botimit është tejet e lavdërueshme, faqe pas faqeje. Përpjekja për ta sjellë në shqip këtë vepër është e Fondacionit "ALSAR", tashmë i mësuar të bëjë përzgjedhje titujsh të këtij niveli. Vetë iniciativa për përgatitjen e këtij libri është shumë më e hershme, siç na bëhet e ditur në parathënien e tij, që diçka më herët se të nisë shekulli në të cilin jetojmë. Si një kontribut i mirëfillt shkencor nën kujdesin e institucioneve përkatëse të shtetit turk, objektivit për t'iu drejtuar si lexuesve në Turqi, por po ashtu dhe lexuesit të huaj, është përmbushur sa ka të bëjë më së paku me botimin në shqip.

Për të shuar kureshtjen, ky libër është nisur nga përgatitësit e tij si një vëllim i vetëm. Përballja me një material të gjerë e ka bërë të detyrueshëm një vëllim të dytë, dhe gjithçka është sjellë në turqisht dhe anglisht. Falë përkushtimit të Fondacionit "ALSAR", ne tani e kemi atë në duar dhe në shqip. Mbi tridhjetë autorë e ekspertë kanë punuar për përgatitjen e këtij libri, na thotë parathënia, por në krye të tij, si përgatitës kryesorë, si autorë, lexohen dy emra, Halil İnalçık dhe Günsel Renda, shkruar dhe të parathënies. I pari, i ndarë nga kjo jetë dy vite të shkuara, është tejet i mirënjohur, një historian turk i jashtëzakonshëm, një shkruar veprash të shumta studimore mbi Perandorinë Osmane, me njohje të gjerë ndërkombëtare, në të gjallë të tij dhe lektor në universitetet më prestigj të botës. Koha e zhvillimit të aktivitetit promovues në kryeqytet, në Tiranë, të botimit në shqip të veprës "Qytetërimi Osman" është e kushtëzuar pikërisht nga ardhja e së bijës së historianit të ndjerë, që ka premtuar pjesëmarrjen. Günsel Renda po ashtu është një historiane e njohur, e specializuar për artin osman, me botime të shumta si autore dhe bashkautore.

Trashëgimia osmane mbetet e fuqishme edhe njëqind vite pas fundit të perandorisë falë atij qytetërimi, të shtrirë në një pjesë të mirë të botës. Siç nënvizohet dhe në hyrje të kësaj vepre, 40 për qind e popullsisë së botës dhe mbi 76 shtete gjenden sot në hapësirën ku ka sunduar kjo perandori. Studime të panumërta ka mbi atë periudhë historike, të risjellë dëndur në ditët e sotme në vëmendje dhe në analizë për shkak të spikatjes së Turqisë së kësaj dekade në arenën gjeopolitike dhe ekonomike globale. Diskutimet dhe ligjërimet mbi otomanizmin, neotomanizmin, mbi qytetërimin osman, janë herë-herë tendencioze nga qarqe të caktuara, me ngjyrimet keqësuese. Duke e parë në këtë pikëpamje, duhet t'i jemi mirënjohës botuesit në shqip të veprës në fjalë, si një pasqyrë e gjerë e një qytetërimi mbresëlënës, të pasur, që ka vënë vulën në historinë botërore. / TE SHESH!



Nga data 15 deri më 19 gusht të këtij viti, poeti dhe studiuesi ynë i shquar, Agim Vinca, ishte pjesëmarrës në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë, i cili u mbajt në qytetin Ramallah të Palestinës. Një mbrëmje e këtij festivali u mbajt në Jerusalem, në pjesën e vjetër të qytetit. Agim Vinca ishte i vetmi poet nga hapësira shqiptare i ftuar në këtë festival, ku poetët i thanë vargjet e tyre në origjinal, në gjuhën amtare, kurse të njëjtat u deklamuan të përkthyer në gjuhën arabe nga aktorët vendas, të shoqëruara edhe me muzikë. Ky ishte kontakti i parë i gjallë i poezisë shqipe me publikun e këtij mjedisi. Por jo vetëm kaq. Nga pena e poetit dhe studiuesit Agim Vinca kësaj radhe vjen edhe një udhëpërshkrim, i përmbledhur në formë mbresash e shënimesh të cilat shprehin pasionin e vëzhgues-

it të kujdesshëm për të veçuar detaje nga jeta dhe pejsazhi i këtij mjedisi, kaq të tensionuar nga konfliktet shumëvjeçare të popujve që jetojnë aty.

Udhëpërshkrimi nga Palestina i poetit Agim Vinca, që fillon nga nesër (e mërkurë) në disa vazhdime, shoqërohet edhe me fotografi autentike, kurse lexuesit e KOH-ës do të kenë rastin të njihen më nga afër me disa pamje që sjell autori, siç janë varri i Krishtit në Jerusalem, xhamia "Al-Aksa" në Jerusalem, muzeu "Mahmud Dervish" në Ramallah, dhe shumë detaje të tjera që vijnë nga udhëpërshkruesi në një frymë objektive dhe tepër mbresëlënëse.

Në përmbyllje të udhëpërshkrimit, autori, ndër të tjera, në notesin e tij kishte shënuar edhe këto mbresa:

"Në Ramallah dhe në kodrat përreth ka shumë ullinj. Madje, si në asnjë

qytet tjetër në botë nga ata që kam parë unë, drurët e ullirit mekokrrat e tyre jeshile qëndrojnë edhe në trotuar si të ishin bimë dekorative.

Çdo ditë, në mëngjes herët, rreth orës pesë, dëgjohet zëri i myezinit dhe thirrja "Allahu ekber", ndërsa fill pas saj kënga e gjelave si një melodi e lashtë, pagane. "Kikiriku" i tyre depërton qartë në dhomën ku fle, me dritare hapur, dhe më zgjon mallin e vendlindjes dhe të fëmijërisë.

Në tokën ku lindën tre religjionet e mëdha: Krishterimi, Judaizmi dhe Islamizmi; ku historia la gjurmët e saj të pashlyera nga lashtësia e deri në kohët moderne, nuk më hiqen nga sytë kokrrat e gjelbra të ullinjve dhe nuk më shlyhet nga veshët kënga e gjelave, që-shpallin ditën e re.

Mirëmbetsh Palestinë!"

# KAMY-PASTERNAK, MIQËSI EPISTOLARE



Në 9 qershor 1958 - Pak pasi Pasternaku ishte shpallur fitues i "nobeli-it" në Letërsi, më 9 qershor 1958, Albert Kamy, i impresionuar nga leximi i "Doktor Zhivago" në frëngjisht, vendos t'i shkruajë nobelistit. Është nga ato letra, ku bonsensi përzihet me ndjenjën e mirë, apo ku entuziazmi përzihet me tundimin për t'i shprehur mirënjohjen autorit. Pasternak jetonte në Bashkimin Sovjetik, duke kaluar peripeci të mundimshme nga regjimi komunist pas publikimit të romanit dhe refuzimit të "nobelit", ndërsa Kamy, në botën e lirë, edhe ai i rrethuar nga fama. Dy nga shkrimtarët më të njohur të mesit të shekullit XX-të, shkëmbyen disa letra mes tyre, nga të cilat, kemi zgjedhur 2 letrat e para, kur përgjigja e Pasternakut, ka ardhur 17 ditë më pas. Bile, e pafirmosur nga ai, për shkak të kontrollit të saj të mundshëm nga KGB-ja...

**KAMY:**

"I dashur Boris Pasternak!  
René Char, që është miku im, më dha adresën tuaj, sepse ai e njej miqësinë dhe admirimin

që unë kam ndjerë prej një kohe të gjatë, për veprën tuaj, si dhe njeriun që ndihet se jeton brenda saj. Doja vetëm të të dërgoja një tekst të shkurtër, rëndësia e vetme e të cilit është ajo e një shenje të largët, por besnike, vlerësimi për ju. Pak prej nesh në Francë ju njohin, që ndajnë jetën tuaj, në një farë kuptimi. Unë, që nuk do të isha asgjë, pashequllin e nëntëmbëdhjetë të Rusisë. Unë gjej tek ju, edhe një herë, Rusinë që më ushqeu dhe më dha forcë. Është e gënjeshtërt të thuhet se kufijtë nuk ekzistojnë. Ata ekzistojnë, përkohësisht. Por në të njëjtën kohë, ekziston një forcë krijimi dhe e të vërtetës, që na bashkon të gjithëve, në përlësi dhe krenari njëkohësisht. Kurrë nuk e kam ndjerë më shumë këtë gjë, se sa kur kam lexuar veprën tuaj, dhe do të doja të shprehja mirënjohjen dhe solidaritetin tim. Ju dërgoj përshëndetje të ngrohta ju dhe familjes tuaj, për veprën tuaj dhe kombin tuaj të madh. Ju shtrëngoj dorën, Alber Kamy!

**PASTERNAK**

"I dashur Z. Kamy,  
E kam të vështirë t'u besoj syve që po ju

(Dy nga letrat që shkrimtarët shkëmbyen me njëri-tjetrin)

shkruaj ju, Z. Kamy. Një faqe e re është hapur në jetën time, ajo e të fituarit të pretekstit, të drejtës, mundësisë, që t'ju tregoj ju kënaqësinë dhe mirënjohjen time, për nuancën speciale në lojën e mendimit të sotëm universal, t'ju them pra, se për këtë ju detyrohem vetëm ju. [...] Rrallëherë kam kohën të lexoj atë që më pëlqen dhe më intereson. Kafka, Faulkneri, ende të palexuar, presin për mua që t'i marr nga rafti i librarisë. "Kujtimi i gjërave të shkuara" është grisur në fundin e "Sodomës dhe Gomorrës". Unë ngazëllem. Ju përgëzoj që shkruani një prozë, leximi i të cilës shndërrohet në një udhëtim të vërtetë: vizitohet vendet që ju përkruani, përjetohet situatat e lidhura me to, i ndiej ato njësoj si personazhet kryesorë... Miqësia ime e re, nëse më lejoni ta them këtë, me ju... është një lumturi e parrëfyeshme, dhe një magji, një përrallë. Unë rrok frymëmarrjen e pakapshme të kopshtit në agim. Unë dua të ndiej misterin e eklipsit të gjelbër të gjetnajtës së dendur, dhe mendoj për René Char, që është të gjitha këto. Ose përndryshe, meditoj për originalitetin absolut të një arti, dhe të asaj që është detyra e artit, jo filozofi – rrokja e esencës së jetës dhe shprehja e qartë e saj... Dhe ju jeni në ankth për atë që mund të më ndodhë mua, dhe harroni se asnjë çmim nuk është i mjaftueshëm për këtë miqësi të re, e cila është pafundësisht me vlerë të jetohet, e madje edhe të vuash për të. Faleminderit, faleminderit për gjithçka.



## Prej nderit të gruas, apo prej dorës së fshehtë të Carit?

(Enigmë ende e pazbuluar vrasja në duel e Pushkinit)

Plot 181 vjet më parë, më 10 shkurt 1837, në një duel të papritur, gjen vdekjen poeti më i madh rus dhe ndër poetët më të mirë të kohërave, Aleksandër Pushkin, në moshën 37 vjeçare. Autori i vrasjes, një oficer francez i quajtur Zhorzh D'Antel, i cili ishte njëkohësisht edhe kunati i tij. Shkaku: Për nder, sepse D'Ante kish shprehur hapur publikisht dashurinë ndaj gruas së Pushkinit, Natalisë.

Të paktën, ky njihet si varianti zyrtar për motivin e duelit që solli vdekjen e parakohshme të poetit.

Por, a ka qenë ky në të vërtetë shkaku i duelit?

Sipas shumë dyshimeve të asaj kohe, vrasësi i vërtetë i Pushkinit, ka qenë dora vetë Cari i atëhershëm i Rusisë, i cili i frikësohej mjaft karizmës, autoritetit dhe ndikimit të poetit në shoqërinë ruse. Thuhet që edhe vetë Pushkini është shprehur në mëse një rast mes miqsh, që i trembej një eliminimi të tij nga Cari, duke aluduar për një gjë të tillë edhe diku në ditarin e tij personal. Po t'i shtosh këtu faktin, që kunati i tij ishte një nga të besuarit e paktë të huaj të Carit, dyshimi përforcohet akoma më shumë. Ndërkohë, pas vrasjes së poetit, sundimtari i ofroi mbështetje të hapur Natalisë së ve dhe fëmijës së vetme që ajo kishte me Pushkinin. Aq më tepër që për vdekjen e poetit u organizua një ceremoni thujse e fshehtë, larg syve të publikut, kur për figurën e tij priteshin ndërrime të mëdha nga oborri i Carit

# AGATA KRISTI-SHKRIMTARJA QË U ZHDUK 11 DITË NGA XHELOZIA..

(Një shenjto e lënduar, apo një grua "hard")?

Autorja më e shitur në botë, Agata Kristi, është zhdukur një herë pa lënë asnjë gjurmë për plot 11 ditë. Ashtu si Edgar Alen Poe, autori tjetër i madh i letërsisë së misterit, dhe ai zhdukur disa ditë, ky fakt përbën një aspekt të errët në biografinë e tyre. Ngjarja, e cila ka mbetur e mistershme edhe sot e kësaj dite, ka ndodhur kur ajo ka qenë 36 vjeçe dhe mesa duket për shkaqe xhelezia. Më 3 dhjetor 1926, Agata hipi në makinën e saj dhe u largua vetëtimthi nga shtëpia, pa njoftuar askënd. Ka qenë pikërisht pak javë para se i shoqi, Arçibald Kristi, t'i kërkonte divor-

cin pas një dashurie me një grua të re, të quajtur Nensi Niele. Për shkak të famës së saj, zhdukja e shkrimtares shkaktoi shqetësim të madh, duke vënë në lëvizje policinë në gjithë territorin e Anglisë. U ngritën mjaft hamendje për fatin e saj, përfshi edhe dyshimin për një vetvrasje të mundëshme, për shkak se veç problemeve në familje, ajo s'kish shumë kohë që kish humbur edhe të emën, idhullin dhe inspiruesen e ëndrrës së saj për t'u bërë shkrimtare e njohur.

Por, tamam kur shpresat, thujse ishin shuar, mbretëresha e

librave "krim", gjendet nga policia e vetme, 11 ditë pasi ishte zhdukur, në një hotel të vogël në veri të Anglisë, në distriktin e Harrogate-s. Agata mësohet t'i ketë thënë policisë, që kish humbur kujtesën, por fakti që në atë hotel ajo figuronte e regjistruar me emrin e dashnores së burrit, mrs. Niele, ngriti hamendje të forta në opinionin e kohës, që gjithçka kish ndodhur nga ndonjë shpërthim i pakontrolluar xhelezia ndaj rivalës së saj. Jo shumë larg hotelit, u gjet dhe vettura e saj e shkatërruar, për të cilën shkrimtarja është shfajësuar që "nuk mban mend asgjë".



Megjithatë, në një gazetë lokale të zonës, u shkruajt edhe për një variant ndryshe të historisë. Shkrimtarja është parë nga mjaft dëshmitarë vendas, e shoqëruar për secilën natë nga burra të ndryshëm, bile edhe e pirë dhe në gjendje të shfrenuar. Ky fakt, përforcohej edhe nga dëshmia e një punonjëseje të hotelit, që e

përshkruan klienten e panjohur si "një grua hard", nga dhoma e së cilës dëgjoheshin gjithmonë natën rënkitime të forta dhe eksituese. Sido të ketë ndodhur, kjo ngjarje s'u përmend më kurrë nga vetë Agata, por po ashtu edhe nga shtypi anglez, duke e lënë si një ndodhi të errët të shkrimtares së famshme.

## Kush ishte Bilall Xhaferri?

Bilall Xhaferri ka lindur më 1935 në fshatin Ninat afër Konispolit, i biri i Xhafer Hoxhës. Babai i tij ishte pushkatuar si antikomunist më 1945. U rrit bashkë me të motrën në internim ku kreu shkollimin. Bëri një shkollë njëvjeçare si gjeometër. Më 1967 i botohet vëllimi me poezi "Lirishta e kuqe", i cili përmban edhe poezi prokomuniste, por nuk u vu kurrë në qarkullim. Po atë vit konkuroi me romanin "Krastakraus" në konkursin letrar të mbajtur me rasin e 500 vjetorit të lindjes së Skënderbeut, por nuk fitoi. Ky roman do të botohej në vitin 1993. Më 1968, ai u shpreh në Lidhjen e Shkrimtarëve kundër romanit Dasma të Kadaresë, duke akuzuar Kadarenë për revizionizëm ndaj doktrinës komuniste, një akuzë kjo shumë e rëndë gjatë regjimit komunist që mund ta kishte dëmtuar shumë Kadarenë. Po për këtë ai u qortua rëndë nga Fadil Paçrami. Autoritetet komuniste nuk mund të lejonin që një person me "njolla në biografi", t'u shkaktonte turbullira, sado që mund të ishte komunist i zjarrtë. Iu hoq e drejta e botimit dhe u internua [6] Pas një mbledhjeje të Lidhjes së Shkrimtarëve me në krye Rita Markon, u kritikua bindshëm dhe u përjashtua.

Më 30 gusht 1969 u arratis nga Shqipëria për në Greqi. Më 1970, shkoi në SHBA, në Boston ku deri më 1972 punoi në gazetën "Dielli". Më 1974 u vendos në Çikago ku themeloi revistën "Krahu i shqiponjës", botim i Lidhjes Çame të cilën e drejtoi, botoi dhe redaktoi për 39 numra në dy gjuhë, shqip e anglisht. Në vitin 1986 vdes në Çikago.


Sipas disa kritikëve Xhaferri nuk ishte fare disident pasi kish shpenzuar kohën e tij duke glorifikuar regjimin komunist, bile ishte ai që akuzoi Ismail Kadarenë se romani "Dasma" kishte denigruar realitetin socialist, për më tepër ai ishte arratisur në Greqi fare kollaj dhe prandaj mendohet që të ishte thjesht një agjent i Sigurimit, dhe se po mbivlerësohet.

Më 3 maj 1993 Presidenti i Republikës Sali Berisha e dekoroi me medaljen "Martir i demokracisë" (Dekreti 1089) me motivacionin "Për përkushtim si publicist e politikan disident në luftën kundër komunizmit e diktaturës, për aspiratat e tij thellësisht kombëtare e demokratike" [2] dhe "Nder i Kombit" nga Presidenti Bamir Topi.

Më 6 maj 1996 shkrimtari Shefki Hysa, drejtues i OJQ Shoqata Kulturore "Bilal Xhaferri", në bashkëpunim me qeverinë shqiptare inicoi dhe organizoi ceremonialin e rikthimit në Atdhe të eshtrave të poetit, prozatorit dhe publicistit të shquar disident Bilal Xhaferri që tanimë prehet në vendlindje, në Sarandë.

Më 2014 shtëpia e tij në Ninat të Sarandës u bë Shtëpi Muze, [9] dhe më 2 nëntor u inaugurua busti pranë shtëpisë.

Bibliografia: Njerëz të rinj, tokë e lashtë (tregime, 1966), Lirishta e kuqe (poezi, 1967), Dashuri e përgjakur (1992), Krastakraus (roman, 1993), Eja trishtim (poezi, 1995), Ra Berati (1995), Përtej largësive (1996)



**BILALL XHAFERRI**  
(1935-1986)

### BALADË ÇAME

*Ylberi, si një përshendetje e përbotur  
lamtumirë,  
u zhduk matane largesive,  
mbi kreshtat e flakëve,  
nëpër shi.  
Matanë largesive u zhduk e perflakur  
Çamëria  
dhe gjitha rruget tona shpien ne veri.  
Ulërin era e Mesdheut mbi trojet e  
lashta epirote,  
mbi të shtrenjtat troje tona  
stërgjiyshore.  
Ne kullotat e braktisura kullosin rrufetë.  
Ullishtet e pavjelura gjemojnë si dallgë  
neper bregore.  
Dhe kudo toka çame,  
mbuluar nga rete,  
rënkton e mbytur ne gjak e lot,  
e mbetur shkrete,  
pa zot.  
Na e tregojne drejtimin plumbat,  
na e ndricojne rruget flake, qe gjithë  
token kane perpire.*

*Pas shpinave tona përplas tufani dyert e shkallmuara te shtepive.*

*Dhe rruget zgjaten e zgjaten ne veri.  
Në, popull muhaxhir, ecim nëpër shi...  
Lamtumirë, Çamëri!*

### NATË ÇAME

*Ndali çapin kopeja e ulqve  
Në errësirën e thinjur me flokë bore.  
Ndali çapin pranë staneve të heshtura  
Kopeja e egër e pyjeve çame.  
S'dëgjohen të lehura, s'dëgjohen blegërima,  
Nuk duken më zjarret ku dremitin çobenët.  
Vetëm deti rreh bregdetin me dallgë pa pushuar,  
Vetëm hëna porsidele e ndarë nga kopeja  
Nëpër shtigjet e reve baret e vetmuar.  
Ndali çapin kopeja e ulqve  
Dhe përgjon e uritur në errësirën thinjoshe.  
Ku ini ju çobenë me gunat e bardha?  
Ku i keni delet që blegërinin kullotave?  
Ku i keni qiprat, ku këmborët si këmbana?  
Ku i keni qent e staneve që ulurinin si luanë?  
Murrot, balot, gudot—armiqtë tanë të vjetër?  
Ku janë që t'u tregojnë me çatallet e hekurt  
Se si në shesh të luftës luftohet për jetën?*

*Hesht në errësirë Çamëria shkretëtirë,  
vetëm dallga rreh parreshtur shkëmbenjtë kryeulur  
Dhe jehona e saj e gjerë nëpër natën joniane  
Përzihet me ulurimen e ulqve të uritur.*

### KOSOVA

*Me ndarje dhe nënndarje gjeografike  
Me ndarje dhe nënndarje historike  
Kosova  
Qe nga ujrart e kulluara të Ohrit  
Deri në errësirën e minierave të Mitrovicës  
Që nga brigjet e kaltra të Ulqinit  
Deri në Qelekullen e në fushën e Nishit  
Kosova  
Fushë e begatshme me fruta e grunore  
Që bie erë pranverës e tëra lule molle  
Kosova me male kreshnike  
Male të zhveshur me pisha e bredhishte  
Që e rrahin qiellin me krahë shqipesh  
Qe e dehin diellin me aromë rrëshire  
Qe e ndezin qiellin me zbardhëllime dëbore  
Kosova  
Krahinë shqiptare që në fillim të saj  
Tokë e Manastirit  
E Prizrenit  
E Plavës dhe e Gucisë  
Tokë e legjendave legjendare të Cjergj Elez Alisë  
Kosova  
Legjendë e mbetur në rrugëkryq të historisë  
Kosova  
Gjithnjë ashtu si gjithnjë  
Me dhëmbë të shtërnguar e me shpirt ndër dhëmbë  
Kosova  
Ku shqiptarët flasin një gjuhë dhe dëgjojnë dy gjuhë  
Kosova gjithnjë ashtu.*

### EJA TRISHTIM



*Eja, trishtim,  
eja me hapa fletësh që bien nga degët,  
eja me hapa shiu që këputet nga fletët...  
Eja, trishtim,  
Eja me hapa tinguish që dridhen në mbrëmje,  
eja me hapa zemrash që rrahin me dhimbje...  
Eja, trishtim,  
o prehër i ëmbël që nuk më braktise kurrë,  
o strehë e qetësisë sime,  
o ëndërrime të mia,  
o gji i shpresës sime!  
Eja, trishtim,  
trishtim, eja.*

# KRYEHERONJTË E LETËRSISË BOTËRORE FLASIN GEGNISHT

Duke mbyllur një cikël shkrimesh për përkthyesit, cikël që zë vend qysh me një shkrim të hershëm mbi Gjon Shllakun e që vazhdon me Pashko Gjeçin, Henrik Lacajn e Guljem Dedën, vlen të hidhet një vështrim mbi kryeheronjtë e letërsisë që falë këtyre katër figurave flasin gegnisht.

Përkthimi i parë që iu bë "Iliadës" së Homerit i kushtoi Gjon Shllakut dekada nga jeta e tij. Në atë përkthim, vokacioni homerik i togvargëshit të parë ishte në gegnisht. Debatu mes Akilit e Agamemnonit ishte në gegnisht. Lutjet e Priamit, atit të Hektorit drejtuar Akilit për t'i kthyer trupin e të birit ishin në gegnisht. Odisea e drejtonte garnizionin e vet duke dhënë urdhra në gegnisht. Gjithë heronjtë e një epi të pavdekshëm flisnin gegnisht.

Ky ep vazhdon me "Odisenë", përkthyer mjeshtrësisht nga Pashko Gjeçi. Vetë Ulisi flet gegni-



sht. Penelopa mërzinë e saj pas një pritjeje njëzet vjeçare e shpreh në gegnisht. Propozimet që i vijnë asaj nga burra që besojnë se tanimë Penelopa është e vejë janë në gegnisht.

Një tërësi personazhesh të vendosur në tabakanë bardh e zi


ku të bardhët janë "të mirët" e të zinjët janë "të këqinjët" flasin me njëri tjetrin, me zanën e me lexuesin në gegnisht. Gjithë perënditë e Olimpiti, në dy librat e lartpërmendur flasin në gegnisht! I madhi Dante, më i madhi i poetëve flet në gegnisht kur viziton Ferrin, Pur-

gatorin e Parajsën. Në gegnisht i drejtohet Virgjilit e në gegnisht jeton çaste të magjishme me Beatriçen. Në gegnisht lexon edhe mbishkrimin në portën e ferrit e në gegnisht kalon shtatë ditë të jetës së tij në botën e përtejme. /Konica

## "Nobel-in" e kanë marrë dhe idiotët"



(Kritiku i famshëm, Harold Bloom, therës me Akademinë suedeze)



Ka edhe persona që tallen me "nobel-in". Dhe jo dosido, por mes tyre edhe kritiku më i madh ndoshta i gjallë i Letërsisë, Harold Bloom.

"Çmimin "nobel" ia kanë dhënë çdo idioti të mundshëm. Bile, idioti të kategorisë së pestë" – është shprehur ai pa asnjë mëshirë për vlerësimet e Akademisë suedeze. "Për cilët do më flisni, për Le Klezio që është i palxueshëm? Për Doris Lessing që ka shkruar një libër të vetëm në jetën e saj, apo për Dario Fo, që është veç një grotesk dështak"? Ai thaujse i urren shkrimtarë të tillë "bessellers", si Stefen King, J.K Rowling, apo Adriene Rich. Harold Bloom, një amerikano hebre 88 vjeçar, konsiderohet nga zërat më autentikë dhe të fortë të kritikës dhe analizës letrare botërore. Ai ka shkruar mbi 40 libra ese, ka studiuar me detaje Shekspirin, për të cilin thotë që 24 nga 39 dramet e tij janë kryevepra, si dhe mbi 30 autorë të shquar të Letërsisë botërore, që nga shek. XIV, deri në ditët tona. Megjithëse ka fobi për pyetjet klishe "kë autorë pëlqeni më shumë?", ai rendit gjithësi: Danten, Shekspirin, Homerin, Folknerin dhe Prustin. Gjithashtu, Bloom ka shpalosur teorinë e tij të përbotshme mbi vlerat e letërsisë. "Qëllimi i leximit duhet të jetë një kënaqësi e vetmuar estetike dhe vetëvlerësimi, sesa të përdoret për përmirësimin e shoqërisë"-thotë ai; qëllim të cilin e konsideron krejt absurd.

(Veçse, anketimi u bë me lexues. Po kritika ç'thotë??)

## "Harry Potter"- zgjidhet sërish i pari i shek.XXI.


Që nga 26 qershori i vitit 1997, kur doli në dritë "Harry Potter dhe guri filozofal", botimi i parë i një serie prej deri tani 8 romanesh, shkrimtarja angleze Joanne Rowling (1965..) ka qenë vazhdimisht në krye të listave të librave më të shitur në botë. Dy javë më parë, në një anketim të kryer nga komuniteti më i madh i lexuesve online "Goodreads" për 10 Librat më të mirë të shekullit të XXI, "Harry Potter dhe dhuratat e vdekjes", pra nr.7 i serisë, u rendit i pari, me një diferencë të dukshme nga vendi i dytë "Lojërat e urisë", i Suzanne Collins. Por, surpriza nuk mbaron këtu. Në dhjetëshen më të mirë, kanë hyrë edhe "Harry..5" dhe "Harry..6", duke lënë jashtë mjaft autorë seriozë në botë, të cilëve s'u është vlerësuar qoftë dhe vetëm një libër.

Por, pavarësisht moshës që i adresohet që dihet lexon më shumë nga moshat e tjera, lind pyetja: Pse Rowling s'ka fituar asnjë çmim letrar vërtet të rëndësishëm??

Dhe pyetja s'është naive. Ajo ndoshta nga shumë fansa të Rowling, mund të shprehë edhe një shqetësim..

Porse, përgjigja mund të variojë në të dy skajet e termometrit.

Sa i përket kritikës profesionale letrare botërore, ajo është ndarë



dy kampe sa i përket "Harry-t.". Njëra pjesë e kritikës, e konsideron romanin thjesht "bestseller", pa ndonjë ndikim të dukshëm në letërsinë e sotme. Pjesa tjetër, megjithëse nuk ka ndonjë mendim më fort të avancuar sa i përket vlerave të tij letrare, thotë megjithatë, që vepra e Rowling,

ka patur një ndikim të jashtëzakonshëm në komunitetin botëror të fëmijëve dhe adoleshentëve, thaujse në 5 kontinentet.

Në fakt, dueli mes letërsisë profesionale dhe asaj më të lehtë e me pak vlera, s'ka nisur në shek.XXI. Përkundrazi. Që në fillimet e romanit modern, Servante-

si e shkruajti "Don Kishotin", pikërisht për të vënë në lojë romanet dhe historirat e sheqerosura kalorsiakë mbushur me aventura dhe delire imagjinare të Spanjës "post reconquiste", pasojë të luftave të përgjakshme të tyre me arabët pas 7-8 shekujsh mbretërimi dhe lulëzimi të kulturës lindore të këtyre të fundit në Andaluzi.

Historia ka vijuar, bile edhe në romanin francez, apo dhe anglez të shek.XVIII-XIX, kohë në të cilën, autorë mediokër janë pritur jo rrallë nga lexuesi më mirë nga kolosët e mëdhenj të letërsisë së këtyre vendeve.

Tjetër fakt anti-Rowling, janë dhe çmimet që ajo ka marrë. Janë shumë, por asnjë aq i rëndësishëm dhe serioz.

Në këtë hulli, mund të përmendim, bile edhe botimet e "Harry-t". Në vende që konsiderohen lider në letërsi dhe arte, si SHBA, Francë, Gjermani etj, ku prestigji i botuesve është mjaft i rëndësishëm, seria e librave të saj, është botuar përgjithësisht nga botues të kategorisë së dytë, ose për fëmijë, për të mos përmendur edhe refuzimin ndonjëherë nga emra të respektuar të kësaj fushe.

Por, pse renditet vazhdimisht "Harry Potter" dhe Rowling në krye të listave të veprave më të kërkuar???





# A MUND TA VIZITOHË THAÇI PRESHEVËN, FLET KRYEMINISTRJA SERBE

Sipas raportimeve të mediave, Thaçi së bashku me Komisionerin për Zgjerim të BE-së, Johannes Hahn të mërkurën pritet të vizitohet komunat jugore serbe ku jetojnë shqiptarët



çfarë do t'i thotë qeverisë së Serbisë, dhe më pas do të vendosim", ka thënë Bërnabiq, transmeton Insajderi.com.

Ajo ka shtuar se "Serbia është vend i cili mund të sigurojë çfarëdo vizitë sepse është stabile dhe ka sovranitet".

Ajo ka vlerësuar se fjalimi i kryetarit serb Aleksandar Vuçiq në Mitrovicën e Veriut është "historik" sepse, siç pretendon "ka ofruar perspektivën e Serbisë së re, stabile e

cila nuk ka pretendime të fitojë në luftëra por në ekonomi".

Duke komentuar incidentet të cilat e kanë përcjellë vizitën e Vuçiqit në Kosovë, ajo pretendon se "edhe një herë është konfirmuar deklarata e saj e mëhershme se liderët momental të shqiptarëve të Kosovës janë të paparashikueshëm dhe se nuk i respektojnë marrëveshjet".

"Për fat të keq ata janë politikanë të luftës, nuk janë politikanë

të paqes, por ne do të punojmë sipas porosive të paqes të cilat i ka dhënë presidenti ynë Aleksandar Vuçiq", ka deklaruar Bërnabiq.

Ndërkaq, Ministri i Brendshëm i Serbisë, Nebojsa Stefanoviq tha sot se ministria që ai drejton do të veprojë në përputhje me urdhrin e gjykatës në rastin e vizitës së Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi në Luginë të Preshevës.

Stefanoviq në pyetje të gazetarëve nëse Serbia do të vepronte në mënyrë diplomatike në rast të shkuarjes së Thaçit "ose do të arrestohej nën akuzat tona", u përgjigj se Serbia është një vend ku ekziston sundimi i ligjit, raportojnë mediat serbe, transmeton Klan Kosova. Sipas raportimeve të mediave, Thaçi së bashku me Komisionerin për Zgjerim të BE-së, Johannes Hahn të mërkurën pritet të vizitohet komunat jugore serbe ku jetojnë shqiptarët, transmeton Klan Kosova.



## Korrigjimi i kufijve – temë e karikaturave botërore

Një nga mediat politike më të njohura në Europë, "Politico", i ka kushtuar në numrin e saj të radhës, karikaturën kryesore në ballinë, zhvillimeve të fundit për një marrëveshje të mundshme mes presidentëve Vuçiq dhe Thaçi, për një "korrigjim kufijsh" mes vendeve të tyre, Serbi dhe Kosovë.

Në karikaturën e realizuar nga Ali Walker shfaqen hartat e Serbisë dhe Kosovës, mbi të cilat secila palë "vizaton" kufij me pistoletë-laps! Mesazhi i goditur duket se ka të bëjë me zhvillimet e fundit, për këtë çështje.

"Pas një debati të madh jo vetëm në shtetet përkatëse, por edhe në ambientet politike ndërkombëtare, ku palët u ndanë në llogore të ndryshme për të ashtuquajturin plan Vuçiq-Thaçi për shkëmbime terriroresh, gjithçka u bllokua ditën e djeshme, kur "papritur" presidenti serb, refuzoi të ulej në bisedën e bisedimeve me presidentin Thaçi në Bruksel. Plani për vizatime kufijsh të rinj mbi hartat e Serbisë dhe Kosovës, nga shumë kancelari të rëndësishme të Europës si Gjermania dhe Britania e Madhe është konsideruar, si një precedent i rrezikshëm për Ballkanin Perëndimor, i cili mund të çojë në një efekt domino edhe për vende të tjera, si Bosnja apo Maqedonia." thuhet në shkrim.

## Caplan: Ndryshimi i negociuar i kufijve mund të normalizojë raportet Kosovë-Serbi

Ndryshimi i negociuar i kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe se një veprim i tillë do të normalizonte raportet midis dyja vendeve.

Kështu ka deklaruar në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Oxfordit, Richard Caplan.

"Luftërat që shkatërruan ish-Jugosllavinë në fillim të viteve të 90-ta u zhvilluan mbi bazën e ndryshimit të kufijve, duke filluar nga Sllovenia dhe Kroacia me kërkesat e tyre që të jenë shtete të pavarura. Megjithatë, këto kanë qenë ndryshime të njëanshme të cilat nuk u pranuan nga autoritetet Federale dhe dy Republikat tjera, Serbia dhe Mali i Zi. Këto ndryshime kufijsh u sfiduan në baza diplomatike, ligjore, politike dhe natyrisht ushtarake".

"Sot, dallimi me situatën midis Kosovës dhe Serbisë është se ndryshimi i kufijve që po shqyrtohet, do të ishte një ndryshim i negociuar dhe rrjedhimisht paqësor.

Ndryshimet konsensuale janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar, dhe se një ndryshim i tillë është arritur edhe gjetiu, si për shembull, shpërbërja e Çekosllovakisë, në dy shtete: Çekinë dhe Sllovakinë më 1993. Ndryshimet konsensuale të kufirit u diskutuan (por pa sukses) edhe në konferencën për Jugosllavinë më 1991", ka thënë ai, transmeton Klan Kosova.

## Ja kush është zyrtari policor që e ndaloj Vuçiqin



Presidenti serb Aleksandar Vuçiq, pavarësisht ndalesës nga kryeministri Ramush Haradinaj, dje sërish mori rrugën në drejtim të Drenicës për të

vizituar fshatin Banjë të Skenđerajt. Por aty Vuçiq nuk mundi të kalojë.

U ndalua dhe u kthye prapësht nga Policia e Ko-

sovës. E lajmin se duket të kthehet prapësht, Vuçiqit ia dha një epror i policisë së Kosovës. Ka qenë zyrtari i policisë, Vllaznim Surdullin nga Gjilani, ai i cili u ballafaqua dje me presidentin serb, njofton Express.

Pavarësisht debatit që Vuçiq pati me Surdullin, ky i fundit nuk lëshoi pe dhe zbatoi vendimin të cilin ia kishin dhënë eprorët e tij.

Fotografia e eprorit Vllaznim Surdullin, u bë virale në internet duke u shpërndarë kështu me qindra herë.

## Komandanti i KFOR: Ishim gati për ndërhyrje, por Vuçiq bëri veprim të mençur

Komandanti i KFOR, Salvatore Cuoci, ka thënë se ishim të gatshëm për të ndërhyrë në protestën që e organizuan dje banorët e Rajonit të Drenicës për të mos i lejuar vizitën në Banjë presidentit serb, Aleksandër Vuçiq.

Ai ka thënë në një intervistë për mediumin serb TV Prva, se Vuçiq bëri veprimin e duhur që vendosi që të tërhiqej, përcjell Klan Kosova.

"KFOR ishte në dispozicion për të ndërhyrë, por dikush prej institucioneve të Kosovës do të duhej të na e kërkonte këtë", ka thënë Cuoci.

"Kur Policia e Kosovës nuk



mund të ndërhyjë në ndonjë situatë, është EULEX, pastaj ne".

"Nëse ne do të ndërhynim, situata do të ishte ndryshe dhe ndoshta vizita do të kishte përfundim tjetër. Por zgjidhja pa-

qësore ishte vendim i mençur [i Vuçiqit]. Cuoci ka theksuar se Policia e Kosovës është përballur me protestuesit dhe se askush nuk ka pësuar lëndime.

Rreth situatës së mundsh-

me nëse KFOR do të reagoje, po që se Kosovën do ta vizitonin ndonjë prej presidentëve të vendeve tjera, ai ka thënë: "Sidoqoftë ai do të ishte president dhe ne do ta bënim të njëjtën".

Kudo, në kontinentin e vjetër, populistët janë në rritje, të shtyrë nga paaftësia e administratave për të menaxhuar fenomenin e migrimit. Për panoramën e vjetër politike, tradicionalisht e ndarë mes popullorëve, socialistëve dhe liberalëve, është një tërmet i vërtetë. Por reagimet ndaj kësaj sfide ofrojnë dy modele të ndryshme

Problemi që shtrohet tani është: cili prej dy modeleve është i destinuar të mbizotërojë, duke parë një rritje të të djathtës ekstreme në Evropë, që të gjithë sondazhet e paraqesin si të pashmangshme në të ardhmen e afërt? Do të mbizotërojë logjika e kordonit sanitar, që i konsideron të panegociueshme disa vlera themelore, në bazë të demokracive evropiane? Apo do të mbizotërojë logjika e njohjes, që do të shtyjë drejt kooptimit të të djathtës populiste, ksenofobe dhe nacionaliste në qeveritë e shtete dhe ndoshta, pas zgjedhjeve evropiane të pranverës së ardhshme, edhe në qeverisjen e BE?

“Veshja e re dhe prestigjioze institucionale”, me të cilën Matteo Salvini uronte të shihte shumë shpejt udhëheqësin e ekstremës së djathtë suedeze, Jimmie Akesson, duhet të presë. Sverige Democra-terna, partia ksenofobe, raciste, nacionaliste dhe antievropiane, ka regjistruar një sukses të fortë duke kaluar 20 përqindëshin që parashikonin sondazhet. Por nuk do të jetë në qeverisje.

Sipas parashikimeve të para, koalicioni i qendrës së majtë, që deri më sot ka udhëhequr vendin

# ÇFARË DO TË BËJË TANI EVROPA, PËRBALLË VALËS SË EKSTREMIT TË DJATHTË?



dhe ai i qendrës së djathtë, do të kenë të drejtën për të qeverisur dhe do të garojnë për këtë. Por të dy, prej kohës kanë përjashtuar mundësinë që ta bëjnë këtë me ksenofobët e Akessonit.

Megjithatë, për socialdemokratët, zgjedhjet e djeshme shënuan një hap të forta pas, një prej rezultateve më të këqinj të historisë së tij, gjatë të cilës kanë krijuar atë “modelin suedez”, që ishte shndërruar në një pikë referimi në nivel planetar. Edhe kur funksionon, edhe kur garanton rritje ekonomike, mirëqenie dhe një administratë efiçente për qytetarët, socialdemokracia duket se e ka

ezauruar aftësinë e saj për të krijuar një konsensus të moderuar si dhe për të folur me njerëzit.

Përveç rritjes së të djathtës ekstreme, ka patur dhe një rritje të fortë të komunistëve, që pothuaj kanë dyfishuar votat. Por rezultati i zgjedhjeve suedeze, lë të kuptohet edhe për një dallim të lehtë që po nis të shquhet në Evropë.

Kudo, në kontinentin e vjetër, populistët janë në rritje, të shtyrë nga paaftësia e administratave për të menaxhuar fenomenin e migrimit. Për panoramën e vjetër politike, tradicionalisht e ndarë mes popullorëve, socialistëve dhe liberalëve, është një tërmet i vërtetë.

Por reagimet ndaj kësaj sfide ofrojnë dy modele të ndryshme. Nga njëra anë janë vendet ku partitë demokratike tradicionale refuzojnë çdo lloj aleance me forca që nuk ndajnë vlerat themelore të liberalizmit evropian. Kjo ka ndodhur në Gjermani, Holandë, Belgjikë, dhe pas një apeli për zgjedhësit gjatë raundit të dytë, edhe në Francë. Kjo do të ndodhë me siguri edhe në Suedi. Në Britaninë e Madhe, e djathta ekstreme e UKIP u shkri në diell madje, pas fitores së referendumit.

Ndërsa në Itali, ashtu sikurse edhe në Greqi, Austri dhe në Finlandë, e djathta ekstreme populi-

ste, nacionaliste dhe ksenofobe u kooptua në qeveri, nga partitë e shumicës që kanë patur iluzionin, me pak apo pa sukses, se mund t'i kontrollonin. Në rastin e Lega Nord, Salvini madje u pranua dy herë: një herë nga Berlusconi dhe Ppe, që bëri koalicion me të për të fituar zgjedhjet, pa ia dalë. Më pas nga Lëvizja Pesë Yjet, që ka pranuar të formojë një qeveri me një parti, vlerat e të cilës bien ndesh me ato që predikon udhëheqja e Beppe Grillos para zgjedhjeve.

Problemi që shtrohet tani është: cili prej dy modeleve është i destinuar të mbizotërojë, duke parë një rritje të të djathtës ekstreme në Evropë, që të gjithë sondazhet e paraqesin si të pashmangshme në të ardhmen e afërt? Do të mbizotërojë logjika e kordonit sanitar, që i konsideron të panegociueshme disa vlera themelore, në bazë të demokracive evropiane? Apo do të mbizotërojë logjika e njohjes, që do të shtyjë drejt kooptimit të të djathtës populiste, ksenofobe dhe nacionaliste në qeveritë e shtete dhe ndoshta, pas zgjedhjeve evropiane të pranverës së ardhshme, edhe në qeverisjen e BE?

Çështja, natyrisht që është e hapur. Vetë Ppe, Partia Popullore Evropiane që nuk ka patur asnjëherë forcën dhe kurajën që të përjashtojë hungarezin Orban, teoricieni i demokracisë joliberales, mund të tundohet të bëjë koalicion me të djathtën ekstreme, për të garantuar një monopol konservator mbi Evropën. Por nuk mund të injorohet se sa e vështirë është që të përmbash dhe kontrollosh infeksionin populist dhe joshjen që ky mund të ketë mbi një elektorat të moderuar. Shembulli i Berlusconit, e tregoi qartë. Por edhe rrëshkitja progresive e CSU bavareze dhe popullarëve austriakë në pozicione ultranacionaliste, duhet të jetë një këmbanë alarmi. Nuk është e thënë që do të dëgjohet.

(La Repubblica)

## Suedi, kryeministri fton “forcat e mira” rreth qeverisë së re

Stockholm – Kryeministri i Suedisë, Stefan Lofven, deklaroi se ka ndërmend të mbajë postin edhe përkundër faktit se partia e tij e majtë shënoi rezultatin më të dobët në zgjedhjet e djeshme të përgjithshme. Lofven, i cili në vitin 2014 solli Partinë Socialdemokrate në pushtet tha se “rezultatet e zgjedhjeve janë ende të paqarta”, por e pranoi se formimi i qeverisë së ardhshme mund të marrë kohë. Ai tingëllonte i padisponueshëm, por gjithashtu me vendosmëri kur iu drejtua mbështetësve se “tani u mbetet partive politike të bashkëpunojnë me përgjegjësi dhe të formojnë një qeveri të fuqishme”. Rezultatet paraprake të zgjedhjeve të së dielës tregojnë se partia e Lofven ka fituar 28,1 përqind të votave, që paraqet humbjen e 13 ulëseve në Parlament. Duke iu përgjigjur rritjes së mbështetjes të Demokratëve Suedeze të ekstremit të djathtë, të cilët mund të kenë



14 deputetë më shumë në përbërjen e re, Lofven tha se “Partia me rrënjë në nazizëm kurrë nuk do të ofrojë asgjë të përgjegjshme përveç urrejtjes”. “Duhet të kemi përgjegjësi morale. Ne duhet të mbledhim të gjitha forcat e mira në vend. Nuk do të dëshpërohemi, por do të organizohemi”, tha Lofven.

## SHBA do të mbyllë zyrën e Organizatës për Çlirimin e Palestinës

Washington - Administrata e presidentit të SHBA-ve Donald Trump ka njoftuar se do të shpallë vendimin për mbylljen e zyrës së Organizatës për Çlirimin e Palestinës në Washington.

Duke u thirrur në deklaratën e një zyrtari të paemëruar të Shtëpisë së Bardhë, gazeta “Amerikan Wall Street Journal” njoftoi se vendimin për mbylljen e zyrës së Organizatës për Çlirimin e Palestinës në Washington do ta shpallë këshilltari i Trumpit për siguri kombëtare John Bolton.

I njëjti burim ka publikuar edhe draftin e tekstit që Bolton do të lexojë, ku thuhet se SHBA-të gjithmonë do të qëndrojnë me aleatin dhe mikun e saj Izraelin.

“Administrata e Trumpit nuk do ta mbajë atë zyrë të hapur përderisa palestinezët refuzojnë të hyjnë në bisedime të drejtpërdrejta dhe konstruktive me Izraelin”, shkruan gazeta amerikane. Në të njëjtën kohë, i njëjti burim

njofton se këshilltari i Trumpit, Bolton do të kërcënojë Gjykatën Ndërkombëtare Penale me sanksione në rast se fillon hetime kundër SHBA-ve dhe Izraelit.

Rreth kësaj çështje deri më tani nuk janë prononcuar as Shtëpia e Bardhë e as Departamenti i Shtetit.

Më parë, Trump pezulloi të gjitha ndihmat për Agjencinë e OKB-së për Refugjatët Palestinezë (UNRWA), duke theksuar se SHBA nuk do të ndihmojë palestinezët për aq kohë sa ata nuk vazhdojnë bisedimet e drejtpërdrejta me Izraelin të ndërmjetësuar nga Washingtoni.

Administrata e Trumpit në disa raste ka thënë se është duke punuar për “marrëveshjen e shekullit”, e cila duhet të zgjidhë krizën në Lindjen e Mesme ndërsa presidenti palestinez ka refuzuar të flasë me zyrtarët amerikanë dhe e quajti planin “shuplaka e shekullit”.

# BBC I BËN NJË ANALIZË TË THELLË KOMBËTARES SHQIPTARE

Ndeshja mes Skocisë dhe Shqipërisë në Ligën e Kombeve ka marrë një vëmendje të veçantë në Britaninë e Madhe, ku presin që skuadra e Aleks Meksit të tregojë fytyrën e saj dhe se është pretendente jo vetëm për të fituar grupin, por edhe për të marrë pjesë në Euro 2020



Edhe rrjeti i njohur "BBC" i ka kushtuar vëmendje kësaj sfide, ndërsa ka publikuar një analizë të mirëfilltë për kuqezinjtë, duke filluar që nga pankina, ku ulet Kristian Panuçi.

"Panuçi mori drejtimin më shumë se një vit më parë, por duhet ende të bindë publikun shqiptar për aftësitë e tij, pasi lufton të zëvendësojë bashkëkombësin e tij Xhani De Biazi, i cili dërgoi Shqipërinë në fazën finale të Euro 2016. Paraqitja në Euro 2016 erdhi pas një fitoreje sensacionale ndaj Portugalisë që në start të kualifikueseve, një rezultat që bën bujë, i cili Skocisë i mungon që nga triumfi në Paris në vitin 2007. Fakti që

Portugalia shkoi të fitonte Euro 2016 thekson edhe më shumë se sa mbresëlënës ishte rezultati, edhe pse Shqipëria nuk kaloi grupin para Francës dhe Zvicrës. Që atëherë, ka pasur rezultate të përziera, megjithëse suksesi i të premtës ndaj Izraelit i jep atyre mundësinë që të kontrollojnë grupin nëse fitojnë në 'Hampden'. Një lajm i mirë për Skocinë është mungesa për dëmtim e disa futbollistëve kyç të Shqipërisë. Mesfushori me eksperiencë Odise Mesfushori me eksperiencë Odise Roshi, sulmuesi Armando Sadiku dhe lojtari i ri i Rejnshërs, Eros Grezda do të mungojnë të gjithë", shkruhet në analizën e "BBC"-së për këtë takim.

Ndërkaq, ky rrjet paraqet edhe tre yjet e Shqipërisë për këtë duel:

"Elseid Hysaj: Luan në zonat e larta të Serisë A me Napolin. Pasi ra në sy me Empolin, mbrojtësi i djathtë 24-vjeçar tani vlerësohet rreth 25 milion paund dhe ishte pjesë e rëndësishme e fushatës për titullin kampion në sezonin e kaluar nga klubi i tij. Ka që tani shumë eksperiencë ndërkombëtare dhe në Ligën e Kampioneve.

Thomas Strakosha: Portieri i Lacios kaloi një natë me shumë punë kur luajti ndeshjen e tij të 7 ndaj Izraelit. 23-vjeçari, i lindur në Athinë, ishte zgjedhje e tretë në Romë, para se të fitonte me forcë

vendin si titullar dy vite më parë. Ai arriti t'i rrëmbente vendin edhe portierit të Shqipërisë në Euro 2016, Etrit Berisha, i cili la Lacion për Atalantën në kërkim të aktivizimit të rregullt.

Taulant Xhaka: Mesfushori 27-vjeçar i Bazelit shënoi golin e tij të parë me kombëtaren kundër Izraelit me një gjuajtje të saktë. I menduar si një objektivi i merkatos së Seviljes, mes të tjerave, futbollisti i lindur në Zvicër është vëlai i madh i Granit Xhakës së Arsenalit, me të cilin e u përball si kundërshtar në ndeshjen historike të Euro 2016 kundër Zvicrës", ishte analiza e "BBC" për tre protagonistët kuqezi.



## Miralem Pjanic thotë se Juventus beson në fitimin e Ligës së Kampionëve

Mesfushori boshnjak mendon se Cristiano Ronaldo ofron diçka ekstra për "Zonjën e Vjetër". "Në Juventus ne luajmë gjithmonë për të fituar kompeticione", tha numri 5 i Juventusit. "Në katër vitet e fundit ne kemi arritur dy finale të Ligës së Kampionëve, dhe kjo nuk është diçka e lehtë për t'u bërë". "Na duhet diçka më shumë për ta fituar këtë trofe. Ne besojmë në këtë ëndërr dhe jemi në rrugën e duhur". "Ronaldo është çelësi ynë, ai ka fituar shumë dhe është njëri ndër më të mirët". "Duke e pasur atë në skuadër na ofron diçka ekstra. Jam shumë i lumtur që qëndrova, objektivi im është që të vazhdoj të fitoj me klubin tim".



## Ricardo Kaka i sjell Milanit Kaka-në e ri!

Ricardo Kaka është rikthyer si drejtues te Milani dhe në pritje të zyrtarizimit ai ka nisur menjëherë punën për t'i dhuruar kuqezinjtë goditën e parë në merkato. Ish fituesi i Topit të Artë po lëviz personalisht për të afruar talentin Lucas Paqueta nga Flamengo, 21-vjeçari i cili luan në të njëjtin pozicion si Kaka. Këtë sezon, Paqueta ka shënuar 6 gola e ka dhuruar 2 asiste ndërsa ka një kontratë deri në 2020 me klubin i cili e vlerëson të paktën 15 milionë euro kartonin e lojtarit.

## Kombëtarja U-21, miqësorja me Italinë, Alban Bushi grumbullon dy futbollistë të rinj

Pas ndeshjes për kualifikueset e Kampionatit Europian, përfaqësuesja e Shpresave do të përballlet të martën me U-21 e Italisë. Prej tre ditësh ekipi i drejtuar nga trajneri Alban Bushi ndodhet në Itali, ku po përgatitet ndeshjen miqësore kundër Shpresave të vendit fqinj. Ashtu si kombëtarja jonë, edhe Italia vjen në këtë përballje pas një humbje me rezultatin 3-0 ndaj Sllovakisë. Ndërkohë për përfaqësuesen tonë kjo do të jetë një sfidë testuese, ndërkohë trajneri Alban Bushi ka thirrur dhe dy futbollistë të rinj për këtë sfidë. Ata janë Kastriot Ndaun në pozicionin



e mesfushorit, që luan për Zyrihun dhe sulmuesi Albion Ademi që luan për Inter Turku. Ndërkohë

qendërmbrojtësi i U-21 të Italisë, Filippo Romanga ka folur për mediat italiane përpara sfidës me Sh-

qipërinë. Ai është shprehur se në këtë ndeshje Shpresat e Italisë do të kërrojnë fitore. "Ne kemi analizuar humbjen e së enjtes së kaluar, kemi bërë disa gabime që çuan në një performancë të keqe dhe një rezultat të keq. Por ne jemi të gatshëm për të ndryshuar. Ne duam të japim një sinjal të fortë se ne jemi të vetëdijshëm se nuk jemi skuadra e ndeshjes së fundit. Duhet t'a nisim nga rreshtimi në fushë. Me trajnerin kemi analizuar gjithçka. Të gjithë jemi të vendosur të ndryshojmë"-është shprehur ish-mbrojtësi i Juventusit, që tashmë luan me Cagliariin.







## Laura Merrin, futbollistja më seksi në planet!

Quket Laura Merrin, është 23-vjeçare dhe luan me përfaqësuesen e Zelandës së Re në futboll për ferma, ndërsa në nivel klubesh aktivizohet me Fylde Ladies FC. Ka me qindra mijëra fansa në rrjetet sociale dhe arsyeja nuk është e vështirë për t'u kuptuar. Nëse i sheh me kujdes fotot e saj bëhet e qartë se është një nga futbollistet më seksi në planet.



# DJOKOVIC "MBRET" NË US OPEN, DEL POTRO NUK REZISTON

Novak Djokovic fiton US Open. Tenisti serb arriti të mundë Juan Martin Del Potron, me rezultatin 6-3 7-6 6-3. Kjo është hera e 3-të që Djokovic shpallet fitues i tuneut amerikan, por dhe Grand Slami i 14 në karrierën e tij, duke barazuar kështu legjendën Pete Sampras. Argentinasi Del Potro nuk kishte rezistencën e duhur për ti bërë ballë Noles, ndoshta dhe prej gjysmë-finales që fitoi kundër Rafael Nadal. Ndeshja filloi mjaft mirë për Djokovic, i cili e fitoi pa problem me rezultatin 6-3. Seti i dytë ishte një spektakël i vërtetë për të gjithë të apasionuarit e tenisit. Të dy tenistët luftuan fort për ta fituar, e madje seti shkoi deri në tiebreak, ku serbi u tregua më i saktë, moment që rezultoi vendimtar për të gjithë ndeshjen. Pavarishtë se Del Potro u mundua të rikthehej në lojë, i ndihmuar shumë dhe nga ovacionet e publikut që e mbështeste, Djokovic fitoi dhe setin e



tretë me rezultatin 6 me 3. Aktualisht, me 14 Grand Slameve të fituara, ai gjendet mbrapa spanjollit Nadal me 17 Grand Slame dhe

zvicrianit Roger Federer me 20. Ky ishte titulli i 2 i rëndësishëm për Novak Djokovic këtë sezon, pas fitores së Wimbledon në korrik. Me

këtë sukses Nole ngjiti tre shkallë në klasifikimin e ATP dhe tashmë pozicionohet i treti pas Nadal e Federer.

## Liverpooli vihet në radhë për Dybala

Liverpooli po interesohet për të marrë Paulo Dybala nga Juventusit dhe nuk përjashtohet mundësia e një oferte në merkaton e janarit të ardhshëm. Pasi Juventusit ka marrë Cristiano Ronaldo, u duk se me largimin e Gonzalo Higuain për te Milani, Dybala do të kishte hapësira në formacionin e Allegrit. Por pikërisht argentinasi ka qenë i sakrifikuari dhe

duke parë moshën e tij, Dybala po që tërheq vëmendjen e shumë klubeve europiane. Dybala ka shënuar 68 gola dhe ka dhënë 25 asiste në 141 ndeshje të luajtura me Juventusin dhe Liverpooli duket se do të bëhet klubi i fundit në radhë i interesuar për të, pasi më parë kanë marrë informacione Real Madrid, Barcelona dhe Manchester United.



Publicitet



## Hamilton në vështirësi, ndjen presion të madh

"Kemi qenë vetëm një apo dy hapa pas, por e mbyllim në pjesën e përparme. Është një ndjesi speciale dhe krenari që besoj se kjo sprovon gjithçka. Mbeten edhe shtatë gara që të siguroj gjithçka, nuk jemi duke fjetur. E dimë se duhet të punojmë më shumë se ata që të thellojmë hendekun e krijuar". Për "Die Welt" Lewis Hamilton rrefen se, pavarësisht triumfit në Monza, ai ndjen presionin e Sebastian Vettel për titullin botëror edhe pse është më tepër se 30 pikë në avantazh nga gjermani në klasifikimin e Formula 1 për pilotët. "Presioni është kaq i madh dhe se gjëja e vetme që mund të bëjë është që të çoj pikë në shtëpi për çdo garë: mund të them që po marr maksimumin nga makina, por iu siguroj që në këto tre gara, nuk e kemi pasur makinën vërtetë në formë. Tensioni është i pranishëm dhe askush nuk mund ta evitojë. Për atë që e sheh nga jashtë është e vështirë ta kuptojë. Presioni është edhe më i lartë se sa kujtimet apo sukseset e mara".



**BOOM FEST**

Alb Kultura

**Shpallet konkurs për pjesëmarrje në festivalin e muzikës zbavitëse shqipe "Boom Fest" 2018, edicioni i parë.** Pjesëmarrësit e interesuar duhet të kenë këngën në WAV format, master ose demo incizim. Për informata më të hollësishme, na shkruani në e-mail adresën.

[boomfestivali@hotmail.com](mailto:boomfestivali@hotmail.com)  
ose në  
tel. +38970622059.

**Konkursi është i hapur deri me 01.10.2018.**





## Çfarë duhet të dimë për kolagjenin

Kolagjeni është një proteinë nga më të pranishmet në organizmin tonë që luan një rol të rëndësishëm për shëndetin dhe bukurinë. Funkcioni i saj është të mbajë qelizat e gjalla dhe të sigurojë elasticitet, rigjenerim të lëkurës, indeve dhe kockave. Por sa dimë ne për këtë proteinë? Emri i saj vjen nga greqishtja që do të thotë "gjeneron ngjitës" dhe prodhohet në mënyrë natyrale nga organizmi. E përbërë nga aminoacidet, fibrat e saj formojnë një rrjet ku zhvillohen dhe riprodhohen qeliza. Ka gjetur përdorim të gjerë në

botën e bukurisë estetike, pasi është thelbësore për ruajtjen e freskisë së lëkurës, indeve lidhëse, zhvillimit të kockave. Madje me kalimin e kohës, kolagjeni është një armë në luftën ndaj osteoporozës. Si ta merrni? Kolagjeni është me shumicë në mishin e kafshëve, dhe mund të merret duke shijuar një supë të mirë, apo tek veza dhe tek perimet, sidomos kërpudhat. Një këshillë e vlefshme? Kujdes me dietën, pasi konsumi i sheqernave dhe karbohidrateve të përpunura pengon prodhimin e kolagjenit.



## Kjo pulë kushton 2 500 dollarë. Arsyja do t'ju habitë

Sa do të paguanit për një pulë? A ju ka shkuar ndonjëherë në mendje se një çift pulash mund të kushtonte deri në 4 999 dollarë? Lloji i pulave Ayam Cemani dallohet sepse ato janë të zeza si në pjesën e jashtme ashtu edhe në atë të brendshme. Puçlat e tyre janë të zeza, sqepat, kthe-trat, madje edhe mishi, eshtrat dhe të gjitha organet e brendshme janë të tilla. I vetmi element jo i zi i këtyre shpendëve është gjaku, i cili ka ngjyrë të kuqe, siç është tek të gjithë kafshët, shpendët dhe njerëzit. Vetëm një pulë 'Ayam Cemani' arrin çmimin deri në 2 500 dollarë. Dana Cowin, kryeredaktorja e 'Food & Ëine', përgjigjet se kjo pulë kushton kaq shumë, "sepse është shumë elegante, e gjitha e zezë. Puçla e saj janë të zeza. Organet e saj janë të zeza. Mishi i saj është i zi. Kështu që është shumë e veçantë, është një pulë e një race të rrallë". Pula ka marrë emrin e një fshati (Cemani) në Javan Qendrore. Për ngjyrën e zezë merita është e një tipari gjenetik i njohur si "fibromelanosis", që është karakteristike e 'Chinese Silkie', një lloj pule e zezë, tepër e çmuar në Kinë.

## Drake pajtohet me reperin e njohur pas shumë kohësh, e fton të performojë në koncert



Drake edhe një herë ka treguar se është i gatshëm të falë e të harrojë. Të paktën kështu ka lënë të kuptohet këtë javë, pasi ka ftuar reperin Meek Mill në një nga koncertet e tij të turneut 'Aubrey and the Three Migos'. Drake dhe Meek Mill nuk i kanë raportet e mira që nga viti 2015, kur Mill me anë të një postimi në Twitter ka 'zbuluar' se Drake nuk i shkruan vetë tekstet e veta dhe ka kërkuar që fansat të ndalojnë së krahasuari me të. Nga ajo kohë, Drake vazhdimi-

sht akuzohet për këtë gjë, ndërsa raportet aspak të mira janë shfrytëzuar për të bërë këngë kundër njëri-tjetrit, ku janë përfshirë edhe reperë të tjerë. Por, ishte Drake ai që është treguar si 'person më i madh', duke e mbështetur reperin gjatë kohës kur është burgosur vitin e kaluar. Ai e ka ftuar Meek Mill dhe kanë performuar bashkë këngën e vitit 2012 "Dreams and Nightmares", duke i befasuar të gjithë kurse më pas janë shprehur shumë të lumtur për këtë pajtim.

## Miliarderja më e re në botë preferon portokallinë



Dhe Kylie Jenner "goditi" sërish rrjetet sociale me pozën e saj para Lamborghiniit që po ashtu e ka në pronësi. Ndoshta ju nuk e keni menduar kurrë që ngjyra portokalli është tërheqëse, por kjo tezë bie poshtë kur e vesh dhe e preferon Kylie. Miliarderja më e re në botë, ka postuar disa fotografi e ulur

para makinës së saj lukzose, e cila ishte kombinuar me të, të dyja me portokalli, më saktë të treja, sepse edhe "bisha" tjetër në sfond i përket 21-vjeçares. Përveç pasurisë, Kylie po shijon edhe ndjesinë e të qenit nënë që nga muaji shkurt i këtij viti, kur në jetë erdhi vajza e saj Stormi.



KALENDARI HISTORIK 11 SHTATOR

1297 – Beteja në Stirling Bridge – Rebeli skocez William Wallace mund anglezët.

1390 – Fillon Lufta Civile në Lituani (1389-1392).

1541 – Shkatërrohet kryeqyteti i Kilit, Santiago nga luftëtarët vendas të udhëhequr nga Michimalonko.

1697 – Beteja e Zentës: Princi Eugen van Savoye mund superfuqinë turke.

1714 – Trupat franceze dhe spanjolle nën Dukën e Bervikit okupojnë Barcelonën.

1802 – Franca përvetëson Mbretërinë e Piedmontit.

1895 – Vidhet FA Kupa në Birmingham.

1912 – Formohet Komiteti Olimpik holandez.

1916 – Gjermanët okupojnë Kavallën në Greqi.

1919 – Marinsat amerikan pushtojnë Hondurasin.

1926 – Spanja largohet nga Lidhja e Kombeve për shkak të inkuadrimit të Gjermanisë.

2001 – Rrëmbehen dy aeroplanë pasagjerësh nga terroristët të cilët pastaj sulmojnë dhe shkatërrojnë Kullat binjake në Nju Jork duke shkaktuar vdekjen e 2,752. Të njëjtën ditë, nga disa terroristët të tjerë rrëmbehet një aeroplan tjetër pasagjerësh dhe e përmbysin mbi Pentagon duke shkaktuar vdekjen e 125 personave.

Flamuri i shtetit amerikan të Alaskës është projektuar nga trembëdhjetëvjeçari Beni Benson



Lojtari i bejsbollit Ray Chapman nga Cleveland Indians është i vetmi njeri në historinë e ligës kryesore të bejsbollit, i cili ka vdekur nga topi i hedhur.

Arinjtë polar dhe pinguinët asnjëherë nuk takohen sepse jetojnë në polet e kundërta të Tokës.



### "3 te mençurit"

Një ditë tre shokë kanë qenë duke biseduar. Njëri prej tyre thotë: "kam dëgjuar se me 13 shtator bora ka me qenë deri në fyt". Tjetri thotë: "Po lëri bre ato llafe se unë sapo dëgjova lajmet me 13 shtator ka me qenë 40 gradë celsius". I treti i dëgjon dhe kthehet e thotë: "Uhh kush po e pastron gjithë atë borë në 40 gradë Celsius".



Unë nuk e di çelësin e suksesit, por çelësi për dështim është të provosh të kënaqësh secilin.

**BILL COSBY**



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS